

SHEJHUL ISLAM IBN TEJMIJE

URDHËRIMI  
PËR TË MIRË

— dhe —

NDALIMI  
NGA E KEQJA

**Urdhërimi për të mirë  
dhe  
ndalimi prej së keqes**

Shejhul Islam Ibn Tejmije

## Përmbajtja

URDHËRIMI PËR TË MIRËN: PEJGAMBERI JONË DHE ATA PARA TIJ.....	8
KY POPULL ËSHTË POPULLI MË I MIRË PËR NJERËZIT....	10
Ç'ËSHTË MA'RUF (E MIRA) DHE MUNKER (E KEQJA)?.....	16
LE TË JETË URDHËRIMI JUAJ PËR TË MIRËN NJË E MIRË NË VETVETE .....	19
DOBITË DUHET TË JENË MË TË MËDHA SE PASOJAT NEGATIVE.....	19
METODOLOGJIA E URDHËRIMIT PËR TË MIRËN DHE NDALIMIT PREJ TË KEQES .....	21
KURTHAT E URDHËRIMIT PËR TË MIRËN DHE NDALIMIT PREJ TË KEQES .....	23
KRYENGRITJA KUNDËR IMAMIT TË MUSLIMANËVE .....	25
PARIMI I PËRGJITHSHËM I URDHËRIMIT DHE NDALIMIT .....	26
ËSHTË E DETYRUESHME QË TË GJITHA GJËRAT TË VLERËSOHEN SIPAS KRITERIT TË SHERIATIT.....	27
DASHURIA NDAJ TË MIRËS DUHET TË JETË NË HARMONI ME ATË ÇKA DO ALLAHU .....	30
DASHURIA DHE URREJTJA E ZEMRËS.....	30
ÇFARË DO TË THOTË SAKTËSISHT EPSH (HAUAA).....	32
PASIMI I EPSHIT NË FETË E MËPARSHME.....	33
ÇKA JANË "PUNËT E MIRA"? .....	38

VEPRA S'ËSHTË E MUNDUR, PËRVEÇ ME DITURI DHE TË KUPTUAR .....	41
NË URDHËRIMIN PËR TË MIRËN LIPSEN BUTËSIA, DURIMI DHE VETËPËRMBAJTJA.....	42
VËSHTIRËSIA E KËTYRE KËRKESAVE.....	45
MOSBINDJA NDAJ ALLAHUT SHKAKTON VËSHTIRËSI, BINDJA SHKAKTON LEHTËSIM.....	46
PREMTIMET DHE KËRCËNIMET ME DËNIM QENË PJESA E PARË E SHPALLJES .....	54
DALLIMET NË LIDHJE ME URDHËRIMIN DHE NDALIMIN JANË SHKAK PËR NDARJE .....	56
MËKATET JANË TË DËSHIRUARA PËR NATYRËN NJERËZORE.....	58
LAKMIA ËSHTË SHKAK I SHMANGIES .....	60
LLOJET E MËKATEVE.....	62
SUKSESI NË ÇËSHTJET E KËSAJ BOTE ARRIHET ME DREJTËSI .....	63
NATYRA NJERËZORE: TIRANI, INAT DHE SHTYPJE.....	64
KATEGORITË E NJERËZVE NË KËTË ÇËSHTJE.....	65
E MIRA DUHET TA MBËSHTESË TË MIRËN, ASHTU SIÇ E KEQJA E MBËSHTET TË KEQEN .....	70
E KEQJA DUHET TË PËRBALLET ME TË MIRËN .....	75
ASHPËRSIA E SPROVËS SHKAKTON NGRITJEN E POZITËS .....	77
DURIMI ËSHTË I DOMOSDOSHËM NË TË BËRIT MIRË .....	78

NEVOJA PËR SIGURINË E BESIMIT.....	78
KRITICIZMI I KOPRACISË DHE FRIKËS.....	81
LLOJET E KOPRRACISË.....	83
KRITICIZMI I FRIKËS .....	85
ÇËSHTJET E NJERËZVE NUK DO TË SHKOJNË NË RREGULL, PËRVEÇ ME GUXIM DHE BUJARI.....	87
Ç'ËSHTË GUXIMI? .....	89
KTHIMI NË DURIM DHE LLOJET E TIJA .....	89
NDALIMI I TEJKALIMIT TË KUFIJVE.....	93
ENTUZIAZMI DHE GUXIMI QË ËSHTË I LAVDËRUESHËM .....	97
KARAKTERI PËR TË CILIN KA NEVOJË BESIMTARI.....	99
FRIKA PREJ RËNIES NË SPROVË SI ARSYETIM PËR NEGLIZHIMIN E URDHËRIMIT PËR TË MIRËN .....	101
ÇDO QENIE NJERËZORE KA NEVOJË PËR URDHËRIM DHE NDALIM.....	105
BIJTË E ADEMIT NUK JETOJNË, PËRVEÇ NË SHOQËRI ...	106
KJO E URDHËRUAR DUHET TË JETË ME ATË TË CILËN E KA URDHËRUAR ALLAHU DHE PEJGAMBERI I TIJ .....	107
KUSH JANË “PËRGJEGJËSIT NGA MESI JUAJ” TË CILËT URDHËROJNË PËR ATË QË ËSHTË E MIRË? .....	109
QËLLIMI I PASTËR KËRKOHEM QË TË KËNAQET ALLAHU NË TË GJITHA VEPRAT E MIRA.....	111
ALLAHU NUK PRANON PREJ NDONJËRIT TJETËR POS ISLAMIT .....	115

DOMETHËNIET E ISLAMIT .....	115
DOMETHËNIA E TË NËSHTRUARIT FYTYRËN ALLAHUT .....	119
DEFINICIONI I VEPRAVE TË MIRA .....	121
DOMETHËNIA E “SUNETIT” NË PREDIKIMIN E SELEFIT <sup>123</sup>	

## **HYRJE**

I gjithë falënderimi i takon Allahut. Ne e lavdërojmë Atë, dhe kërkojmë ndihmën dhe faljen e Tij. Kërkojmë strehim tek Allahu nga e keqja që është brenda nesh, dhe nga e keqja e veprave tona. Atë që e udhëzon Allahu, askush s'mund ta humbë; atë që Allahu e humb, askush s'mund ta udhëzojë.

Dëshmoj se askush nuk meriton të adhurohet përveç Allahut, i Cili është pa ortak, dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij. Allahu e dërgoi atë me udhëzim dhe rrugën e së vërtetës, ashtu që Ai ta lartësojë atë mbi të gjitha mënyrat tjera të jetës. Allahu mjafton si dëshmitar. Allahu dërgoftë bekimet dhe përshëndetjet e Tij mbi Muhamedin dhe mbi njerëzit e Muhamedit.

Urdhërimi për të mirën dhe ndalimi prej të keqes është ajo me të cilën Allahu i dërgoi librat e shpallura, dhe me këtë Ai dërgoi të Dërguarit e Tij, dhe kjo është pjesë integrale e rrugës (fesë). Porosia e Allahut përbëhet nga pjesët informative dhe udhëzuese. Për sa u përket atyre informative, Allahu na informon për veten e Tij, siç është teuhidi (monoteizmi), apo informimi që Ai na e bën në lidhje me krijimin e Tij, siç janë rrëfimet e njerëzve dhe Pejgamberëve të mëparshëm, të cilat përmbajnë mësim, kërcënime dhe premtime. Pjesa udhëzuese konsiston në urdhrat që duhet bërë, urdhërat që s'duhet bërë, dhe gjërat të cilat i mbeten zgjedhjes dhe diskrecionit tonë.

Kështu, është përmendur në hadith se kaptina e Kur'anit e cila fillon me: **Thuj: Ai është Allahu. I Vetmi...**, është e barabartë me një të tretën e Kur'anit, për shkak se kjo përfshin të tretën e teuhidit. Kur'ani përbëhet nga teuhidi, urdhrat, dhe ngjarjet historike.



## URDHËRIMI PËR TË MIRËN: PEJGAMBERI JONË DHE ATA PARA TIJ

Allahu ka thënë duke e përshkruar Muhamedin (salallahu alejhi ue selam):

Ai i urdhëron ata në atë që është e mirë dhe ua ndalon atë që është e keqe. Dhe Ai ua lejon atyre atë e cila është e pastër dhe e mirë, ndërsa ua ndalon atë e cila është e papastër dhe e urryer. (Kur'an 7:157).

Kjo sqaron përsosurinë e porosisë së Pejgamberit Muhamed (salallahu alejhi ue selam). Ai është në gjuhën e të cilit Allahu e ka urdhëruar tërë atë që është e mirë, e ka ndaluar tërë atë që është e keqe, ka lejuar çdo gjë të pastër dhe ka ndaluar çdo papastërti apo send të dëmshëm. Për këtë arsye, është transmetuar se Pejgamberi ka thënë:

“Unë jam dërguar që t’i plotësoj cilësitë e karakterit të mirë.” Dhe ai tha në hadithin e vërtetë:

“Shembulli ime në lidhje me pejgamberët e tjerë të Allahut, është sikurse shembulli i njeriut që e ka ndërtuar një shtëpi. Ai plotësoi dhe përsosi çdo gjë në lidhje me shtëpinë, përveç vendit të një tulle të vetme. Njerëzit kalonin pranë shtëpisë dhe shprehnin kënaqësinë ndaj bukurisë së saj, por ata thoshin: “Vetëm sikur të mos mungonte edhe kjo tullë.” Unë jam ajo tullë, dhe unë jam vula e Pejgamberëve.”

Përmes Muhamedit, Allahu e plotësoi rrugën (fenë) e cila përfshin urdhërimin e të gjitha të mirave, ndalimin e

të gjitha të këqijave, lejimin e çdo gjëje të pastër, dhe ndalimin e çdo gjëje të papastër. Për sa u përket Pejgamberëve që erdhën para tij, porosia e tyre nganjëherë përmbante ndalimin e disa gjërave të pastra dhe të mira, siç ka thënë Allahu:

Për shkak të disa krimeve të bëra nga Çifutët, Ne ua ndaluan atyre disa gjëra të pastra, të cilat u qenë lejuar atyre. (Kur'an 4:160)

Po ashtu, porosia e tyre nganjëherë nuk i ndalonte të gjitha gjërat e papastra siç ka thënë Allahu:

Tërë ushqimi u qe lejuar bijve të Israilit, përveç atij të cilin ata e zgjodhën që t'ia ndalojnë vetes para se ta zbritnim Teuratin. (Kur'an 3:93)

Ndalimi i gjërave të papastra është i përfshirë në domethënien e ndalimit prej të keqes, mu ashtu siç lejimi i të gjitha gjërave të pastra është i përfshirë në domethënien e urdhërimit për të mirën. Kjo sepse ndalimi i gjërave të mira dhe të pastra është pjesë e asaj çka Allahu ka ndaluar. Kështu, urdhërimi për të gjitha të mirat dhe ndalimi i të gjitha të këqijave nuk është plotësuar, përveç në Pejgamberllëkun e Muhamedit (salallahu alejhi ue selam) me anë të cilit Allahu plotësoi cilësitë e karakterit të mirë, gjë që përfshin tërë atë që është e mirë. Allahu thotë:

Në këtë ditë Unë e kam përsosur për ju fenë tuaj, dhe e kam plotësuar dhuntinë Time ndaj jush, dhe e kam pranuar për ju Islamin si fe.

Allahu e ka përsosur rrugën për ne, e ka plotësuar dhuntinë e Tij ndaj nesh, dhe e ka pranuar për ne Islamin (nënshtrimin) si mënyrë tonën të jetesës.

## **KY POPULL ËSHTË POPULLI MË I MIRË PËR NJERËZIT**

Allahu i ka atribuuar popullit të Muhamedit karakteristikat e njëjta, të cilat Ai ia ka atribuuar vetë Pejgamberit në ajetin paraprak kur Ai tha:

Ju jeni populli më i mirë i ngritur për njerëzimin: ju jeni që urdhëroni për të mirën dhe ndaloni prej të keqes, dhe ju besoni në Allahun. (Kur'an 3:110).

Dhe Ai tha:

Besimtari dhe besimtarja janë mbrojtës të njëri-tjetrit: ata urdhërojnë për të mirën dhe ndalojnë prej të keqes. (Kur'an 9:71)

Me domethënie të njëjtë, Ebu Hurejre, një shoqërues i Pejgamberit dhe transmetues i shumë haditheve thoshte:

“Ju jeni njerëzit më të mirë për njerëzit. Ju i lidhni ata me zinxhirë e pranga dhe i tërhiqni drejt Parajsës.”

Allahu shpjegon në ajetin e lartpërmendur atë se ky popull është populli më i mirë për njerëzit d.m.th. më i dobishmi për ta, ai i cili ua bën të mirën më të madhe atyre. Kjo sepse ata përbëjnë të mirën dhe dobinë totale përmes urdhërimit për të mirën dhe ndalimit prej të keqes

nga ana e tyre, në cilësi dhe sasi, meqë ata urdhërojnë tërë atë që është e mirë dhe ndalojnë tërë atë që është e keqe, dhe porosia e tyre i është adresuar të gjithë njerëzve të botës. Për më tepër, ata e mbështesin këtë institucion me xhihad (përpjekje) në rrugën e Allahut me jetët dhe pronat e tyre, dhe kjo përbën dobinë e plotë për botën.

Për sa u përket popujve të mëhershëm, asnjë prej tyre nuk i ndalonte të gjithë njerëzit me tërë atë që është e mirë, e as që i ndalonin të gjithë njerëzit në tërë atë që është e keqe.

Për më tepër, ata nuk bënë xhihad (përpjekje) në këtë kauzë. Disa prej tyre fare nuk janë angazhuar në luftë të armatosur, dhe ata që e bënë këtë, siç janë Çifutët, lufta e tyre përgjithësisht ishte me qëllim që t'i dëbojnë armiqtë e tyre nga toka e tyre, apo siç lufton çdo popull i shtypur kundër shtypësit të tyre, e jo me qëllim për të thirrur njerëzit në udhëzim dhe drejtësi, e as që t'i urdhërojnë ata për të mirën dhe t'i ndalojnë prej të keqes. Allahu rrëfen diskutimin vijues në mes Musait dhe pasuesve të tij:

O njerëz, hyni në tokën e shenjtë, të cilën Allahu e ka caktuar për ju, dhe mos ikni e që më pas të gjendeni në një humbje të mjerë. Ata thanë: "O Musa, aty janë një popull i ashpër (luftarak), dhe ne s'do të hyjmë në të derisa ata të dalin – nëse ata dalin, atëherë ne do të hyjmë në të." ...Ata thanë: "O Musa, ne s'do të hyjmë në të derisa ata të jenë aty, pra shko ti, ti dhe Zoti yt, dhe luftoni. Ne do të ulemi mu këtu. (Kur'an 5:21-24)

Allahu thotë në një tjetër ajet:

A nuk e keni parë tubimin e bijve të Israilit pas kohës së Musait kur ata i thanë Pejgamberit të tyre: “Caktoje për ne një mbret që të luftojmë në rrugën e Allahut.” Ai tha: “Ndoshta ju s’do të luftoni atëherë, nëse lufta do t’ju urdhërohej?” Ata thanë: “Pse të mos luftojmë në rrugën e Allahut, kurse ne jemi dëbuar nga shtëpitë dhe fëmijët tanë?” Pastaj, kur lufta u qe urdhëruar atyre, ata e kthyen shpinën, të gjithë përveç disave, dhe Allahu ka njohuri të plotë për keqbërësit. (Kur’an 2:246)

Këtu ne shohim se ata që flasin me këtë Pejgamber, e cekën arsyen për të luftuarit e tyre, atë se ata kishin qenë dëbuar nga shtëpitë e tyre dhe fëmijët e tyre. Përkundër kësaj, shumica e tyre dështuan që ta përmbushin fjalën e tyre, kur atyre u qe urdhëruar të luftojnë. Për këtë arsye, ata s’qenë lejuar që të mbajnë çfarëdo plaçke të luftës, dhe s’qenë lejuar t’i zënë robër femrat.

Është mirë e njohur se populli më i madh i besimtarëve para nesh ishin të bijtë e Israilit. Kjo është transmetuar në hadithin e vërtetë të rrëfyer nga Ibn Abas, se Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) ka thënë:

“Popujt e mëhershëm dhe pejgamberët e tyre më janë treguar mbrëmë. Një pejgamber kalonte me një njeri, tjetri me dy njerëz, një tjetër më një grup të vogël, dhe një tjetër që s’kishte asnjë me vete. Pastaj, unë pashë një grumbull të madh, kodra të vogla të mbushura me njerëz, dhe unë thashë: “Ky është Umeti im!” M’u tha: “Këta janë bijtë e Israilit, por shiko atje.” Pastaj unë pashë një grumbull të

madh, i cili zinte horizontet. M'u tha: "Ky është Umeti yt, dhe në mesin e tyre janë shtatëdhjetëmijë që do të hyjnë në parajsë pa u marrë në llogari." Dëgjuesit e Pejgamberit u shpërndanë pa u dhënë ndonjë shpjegim i mëtutjeshëm. Pastaj, shoqëruesit (sahabët) diskutuan për këtë çështje duke thënë: "Përsa na përket neve, ne qemë lindur në idhujtari, por kemi besuar në Allahun dhe të Dërguarin e Tij...por këta janë bijtë tanë. Kur spekulimi i tyre për atë se kush janë shtatëdhjetëmijë njerëzit i mbërriu Pejgamberit, ai tha: "Ata janë që nuk e praktikojnë shërimin me zjarr, apo që s'përdorin fjalë magjike (të besuarit në aftësi magjike për shërimin apo parandalimin e sëmundjeve), që nuk besojnë në ogur, dhe të cilët plotësisht i mbështeten Zotit të tyre." Ukashe ibn Mihsan u ngrit dhe tha: "A jam unë njëri prej tyre, O i Dërguar i Allahut.?" Pejgamberi tha: "Po". Kur një tjetër u ngrit dhe tha të njëjtën gjë, Pejgamberi tha: "Ukashe erdhi para teje."

Nga kjo ne kuptojmë përse konsensusi i këtij Umeti është dëshmi, d.m.th. sepse Allahu na ka informuar se ata urdhërojnë tërë atë që është e mirë, dhe ndalojnë prej tërë asaj që është e keqe. Nëse ata (Umeti Musliman) do të pajtoheshin të gjithë që të lejojnë diçka të ndaluar, ta lënë një detyrë, të ndalojnë diçka të lejuar, apo të thonë ndonjë të pavërtetë për Allahun apo krijimin e Tij, ata do të ishin urdhërues në atë që është e gabuar, ndalues të asaj që është e mirë, dhe kjo sigurisht se nuk është nga të folurit e pastër dhe punët e mira. Krahas kësaj, nga ajeti nënkuptohet se çfarëdo qoftë që Umeti nuk ka urdhëruar s'është e mirë, dhe çfarëdo qoftë që nuk ka ndaluar s'është e keqe. Meqë ky është Umet që urdhëron të gjitha të mirat,

dhe ndalon të gjitha të këqijat. S'është e mundur për tërë Umetin që të urdhërojë diçka që është e keqe, e as të ndalojë diçka që është e mirë.

Mu ashtu siç na ka informuar Allahu se ky Umet do të përmbushë këtë detyrë, Ai po ashtu e ka bërë këtë detyrë kolektive (fard kifaje) për Umetin Musliman duke thënë:

Le të jetë një grup nga mesi juaj që thërret në atë që është e mirë, urdhëron për të mirën dhe ndalon prej të keqes. Këta janë të suksesshmit. (Kur'an 3:104)

Nuk është detyrë e praktikuesit të urdhërimit për të mirën dhe ndalimit prej të keqes që të shpërndajë porosinë ndaj çdokujt në botë. Një gjë e tillë nuk është kërkuar as nga Pejgamberët (paqja qoftë mbi ta), dhe kjo është një ndihmesë ndaj porosisë Pejgamberike. Më saktë, ajo që kërkohet është që kjo të bëhet e arritshme për ata që e kërkojnë atë. Nëse ata tregohen neglizhentë në kërkimin e saj, ndonëse ajo u është bërë e arritshme, atëherë përgjegjësia bie mbi ta, jo në atë. Meqë urdhërimi për të mirën është detyrë kolektive, ashtu siç Kur'ani qartë tregon. Ajo s'është detyrë për secilin individ Musliman, por për ta si grup.

Meqenëse xhihadi është pjesë e përsosjes nëse urdhërohet për të mirën dhe ndalohet prej të keqes, kjo, po ashtu, është detyrë kolektive. Përsa i përket detyrimit kolektiv, kjo do të thotë se nëse ata që janë të ngarkuar me detyrën nuk e zbatojnë atë, atëherë çdonjëri që ka mundësi për të në çfarëdo shtrirje është në mëkat aq sa është shtrirja e mundësive të tija në atë zonë. Kjo sepse detyrimi i tij

(xhihadit) kur ka nevojë për të, i takon çdo Muslimanit aq sa është shtrirja e mundësive të tija/saj, siç ka thënë Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) në hadithin që gjendet në Muslim:

“Kushdo prej jush që sheh duke u bërë ndonjë e keqe, le ta ndërrojë atë me doren e tij (me forcë). Nëse ai s’ka mundësi ta bëjë këtë, atëherë me gjuhën e tij, dhe nëse s’ka mundësi ta bëjë këtë, atëherë me zemrën e tij.”

Meqë kështu qëndron puna, është e qartë se urdhërimi për të mirën dhe ndalimi prej të keqes është njëra prej të mirave me të mëdha të cilën jemi urdhëruar ta bëjmë.



## Ç'ËSHTË MA'RUF (E MIRA) DHE MUNKER (E KEQJA)?

Zbatimi i dënimeve të urdhëruara nga Allahu ndaj kujtdo qoftë që shkel kufijtë e sheriatit, është pjesë e ndalimit prej të keqes. Është detyrë për ata në pushtet (Ulu-ul- amr) d.m.th. dijetarët nga secili grup apo popull, udhëheqësit e tyre, dhe të vjetrit e tyre, që të qëndrojnë mbi popullatën e përgjithshme duke i urdhëruar ata për të mirën dhe duke i ndaluar prej të keqes; kështu duke i urdhëruar ata në tërë atë që ka urdhëruar Allahu dhe i Pejgamberi i Tij. Për shembull, vendimi i Ligjit Islamik (Sheriatit) - kjo është pesë namazet ditore në kohën e duhur të tyre, lëmosha e detyrueshme, agjërimi i detyrueshëm, dhe pelegrinazhi në Meke. Po ashtu, besimi në Allahun, engjëjt e Tij, Librat e shpallura të Tij, Pejgamberët e Tij, Ditën e Gjykimit, besimi në paracaktimin e të gjitha gjërave - të mirën dhe të keqen, dhe koncepti i Ihsanit (niveli më i lartë i imanit apo besimit) që do të thotë të adhurohet Allahu sikur të shihej Ai, sepse vërtet, edhe nëse ju nuk e shihni Atë, Ai gjithmonë ju sheh. Për më tepër, e mira (ma'ruf) përfshin çdo gjë, së jashtmi dhe së brendshmi, e cila qe urdhëruar nga Allahu dhe Pejgamberi i Tij. Këtu përfshihen: sinqeriteti absolut (ikhlas) ndaj Allahut, mbështetja në Allahun (teuekul), që Allahu dhe Pejgamberi i Tij të jenë më të dashur për besimtarin se gjithkush tjetër, shpresa për mëshirën e Allahut dhe frika ndaj dënimit të tij, durimi me caktimin e Allahut dhe dorëzimi i plotë ndaj

urdhrit të Tij, të qenit i vërtetë në të folur, përmbushja e detyrave, kthimin e amaneteve pronarëve të tyre, mirësjellja ndaj prindërve, mbajtja e lidhjeve familjare, bashkëpunimi në të gjitha aktet e mira, bamirësia dhe bujaria ndaj fqinjëve, jetimëve, njerëzve të varfër, udhëtarëve të mbetur keq, shokëve, bashkëshortëve, shërbëtorëve, drejtësi dhe paanësi në të folur dhe vepra, duke i thirrur njerëzit në karakter të mirë, si dhe aktet e vetëpërmbajtjes siç janë vendosja e marrëdhënieve me ata të cilët janë ndarë, të dhënit atyre që të refuzojnë, dhe falja e atyre që ju bëjnë keq. Urdhërimi i njerëzve që të jenë së bashku dhe kooperativë, dhe të ndalurit ata nga mospajtimet dhe ndarja në mes tyre po ashtu është pjesë e urdhërimit në atë që është e mirë.

Për sa i përket të keqes (munker) të cilën Allahu dhe Pejgamberi i Tij e kanë ndaluar, forma më e rëndë dhe e fundit e saj është të shoqëruarit ortak me Allahun. Shoqërim do të thotë që t'i lutemi ndokujt apo diçkaje tjetër krahas Allahut. Ky ortak mund të jetë dielli, hëna, yjet apo planetët, ndonjë engjëll, njëri nga Pejgamberët, ndonjë njeri i drejtë apo shenjtor, ndonjë prej xhinëve, fotografitë apo varret e ndonjërit prej këtyre, apo çdo gjë tjetër në të cilën thirret përveç Allahut të Lartësuar. Shoqërim (shirku) po ashtu është kërkimi i ndihmës nga ndonjë nga këto që u përmenden më lart, apo të bërit sexhde atyre. E tërë kjo dhe çfarëdo e ngjashme me këtë është shoqërim (shirk) i ndaluar nga Allahu në gjuhët e të gjithë Pejgamberëve të Tij.

Çdo gjë të cilën Allahu e ka ndaluar po ashtu është pjesë e së keqes, siç është mbytja e paarsyeshme, uzurpimi i pronës së njerëzve në mënyra të ndaluara, uzurpimi i pronës me dhunë apo frikësim, kamata, bixhozi, të gjitha llojet e shitjeve apo kontratave të cilat Pejgamberi i ka ndaluar, ndërprerja e lidhjeve familjare, ashpërsia ndaj prindërve, mashtrimi në peshim dhe matje, dhe çfarëdo forme e shkeljes në të drejtat e të tjerëve. Po ashtu, në këtë kategori janë të gjitha aktet e shpikura të “adhurimit” të cilat Allahu dhe Pejgamberi i Tij s’i kanë urdhëruar apo lejuar.

## **LE TË JETË URDHËRIMI JUAJ PËR TË MIRËN NJË E MIRË NË VETVETE**

Mirëdashësia dhe simpatia janë mënyra korrekte për urdhërimin e të mirës dhe ndalimit prej të keqes. Për këtë arsye, është thënë:

“Le të jetë urdhërimi juaj për të mirën një e mirë në vetvete, dhe le të mos jetë i keq ndalimi juaj prej të keqes.”

## **DOBITË DUHET TË JENË MË TË MËDHA SE PASOJAT NEGATIVE**

Duke qenë urdhërimi për të mirën dhe ndalimi prej të keqes njëra prej detyrave më të mëdha apo akteve më të lavdërueshme në Islam, është e domosdoshme që dobia këtu të jetë më e madhe se pasojat e saj negative. Ky është shpirti i përgjithshëm i porosive të Pejgamberëve dhe librave të shpallur, dhe Allahu nuk e pëlqen kaosin dhe çoroditjen.

Tërë ajo çka Allahu ka urdhëruar është e dobishme dhe mëshirë e dobisë. Allahu e ka lavdëruar namazin (të kundërtën e çoroditjes) dhe “muslihin” (reformuesit, apo ata të cilët nxisin në namaz). Dhe Ai i ka lavdëruar ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira (salihat), kurse e ka dënuar çrregullimin (fesad) dhe ata që e shkaktojnë atë në shumë vende në Kur’an. Kështu, kurdo që efektet e

kundërta (mafsada) të ndonjë akti të urdhërimit apo ndalimit janë më të mëdha se dobia e tij (maslaha), kjo s'është më pjesë e asaj që Allahu në ka urdhëruar neve, edhe nëse është rasti që të lihen detyrat apo të bërit e të ndaluarës. Kjo sepse besimtarit i takon që t'i frikësohet Allahut në lidhje me robërit e Tij, dhe udhëzimi i tyre s'është përgjegjësi e tij. Kjo është pjesë e domethënies së ajetit në të cilin Allahu thotë:

O ju që besoni, ruajeni veten tuaj! Ai që shmanget s'do t'ju dëmtojë kur jeni në rrugë të drejtë. (Kur'an 5:105)

“Mbajtja me udhëzim” arrihet vetëm duke përmbushur dhe zbatuar të gjitha detyrat. Kështu, kur një Musliman e bën atë që është e detyrueshme për të duke urdhëruar për të mirën dhe ndaluar prej të keqes, mu ashtu siç i ka përmbushur të gjitha detyrat tjera, shmangia e atyre që shmangen nuk do t'i bëjë atij ndonjë dëm.

## METODOLOGJIA E URDHËRIMIT PËR TË MIRËN DHE NDALIMIT PREJ TË KEQES

Urdhërimi për të mirën dhe ndalimi prej të keqes nganjëherë bëhet me zemër, nganjëherë me gjuhë, dhe nganjëherë me dorë (forcën fizike). Për sa i përket praktikimit të saj me zemër, kjo është e detyrueshme për çdonjërin në çdo kohë dhe çdo situatë, meqë praktikimi i tij nuk sjell vështirësi. Kushdo që dështon që ta bëjë së paku këtë, s'është besimtar, si në versionin e plotë të hadithit të cituar paraprkisht:

“Kushdo prej jush që sheh duke u bërë ndonjë e keqe, le ta përmirësojë atë me dorën e tij; nëse s'ka mundësi, atëherë me gjuhën e tij, dhe nëse s'ka mundësi, atëherë me zemrën e tij dhe ky është besimi më i dobët – apo në një version tjetër: përtej kësaj s'ka iman as sa një farë e vetme e mustardit.”

Ibn Mes'ud qe pyetur njëherë: “Kush janë të vdekurit e gjallë?” ai u përgjigj:

“Ai i cili nuk e vërteton të mirën/të drejtën si të tillë dhe nuk e refuzon të keqen/të gabuarën.

Ai i referohet personit të përshkruar në hadithin e vërtetë, i cili vazhdimisht dështonte në refuzimin e së keqes sa herë që ai sprovohej. Pejgamberi tha:

“Sprovat i tregohen zemrës sikur hasër (e kashtës), kashtë për kashtë. Cilado zemër që i pranon ato dhe i thith ato, e fiton një pikë të zeze në të, dhe cilado zemër që i

refuzon ato, e fiton një pikë të bardhë e të pastër në të. Kjo vazhdon derisa zemrat të jenë dy llojesh: zemra e cila është e bardhë, e qetë, dhe e pastër sikur guri i shkëlqyer, e cila s'do të dëmtohet nga sprovat e mëtutjeshme për sa të jenë qiejt dhe toka; dhe tjetra e errët dhe e njollosur, e cila është sikurse grepi i kthyer në anën e kundërt në të cilën asgjë s'mund të varet – ajo as nuk e pranon atë që është e vërtetë as nuk e refuzon atë që është e keqe, përveç asaj që përkon me epshet dhe prirjet e tija në të cilën zemra e tij plotësisht është zhytur.”

## KURTHAT E URDHËRIMIT PËR TË MIRËN DHE NDALIMIT PREJ TË KEQES

Dy grupe njerëzish gabojnë në këtë fushë:

Njëri grup e lë atë që është e detyrueshme për ta në sferën e urdhërimit për të mirën dhe ndalimit prej të keqes, duke u ngjitur në interpretimin e gabuar të ajetit që u citua më lart:

O ju që besoni, ruajeni veten tuaj! Ai që shmanget s’do t’ju dëmtojë kur jeni në rrugë të drejtë. (Kur’an 5:105)

Ebu Bekr e shpjegoi këtë gabim në një hutbe duke thënë:

“O njerëz, vërtet ju e lexoni këtë ajet dhe e aplikoni aty ku ai nuk përket, sepse e kam dëgjuar Pejgamberin (salallahu alejhi ue selam) duke thënë: Vërtet, kur njerëzit e shohin keqbërësin dhe nuk e ndalojnë atë, Allahu do t’i godasë me një dënim të përgjithshëm.”

Grupi i dytë dëshiron që të urdhërojë në të mirën dhe të ndalojë prej të keqes me gjuhët dhe duart e tyre absolutisht dhe në çdo situatë pa dituri të mjaftueshme të sheriatit, pa vetëpërmbytje, pa durim, e pa kujdes për atë që është e dobishme dhe atë që ka më shumë dëm sesa dobi, dhe atë që është e mundur dhe atë që s’është e mundur. Kjo është sikurse në hadithin e transmetuar nga Ebu Tha’lebe el-Khushenij:

“... urdhërojeni njëri-tjetrin në atë që është e mirë dhe ndalojeni atë që është e keqe derisa të shihni bindje ndaj



lakmisë dhe pasimit të epsheve, preokupimin me këtë botë dhe mahnitjen absolute të çdonjërit me mendimin e vet. Kur të shihni situatë mbi të cilën ju nuk keni kurrfarë mundësie, ajo që ju takon atëherë janë çështjet private. Se vërtet, Ditët e Durimit janë duke ardhur. Durimi në ato ditë është sikurse shtrëngimi i prushit të nxehtë me dorën tuaj. Shpërblimi i atij i cili i përmbush të gjitha detyrat e veta në ato ditë është i barabartë me shpërblimin e pesëdhjetë njerëzve të tillë sot.”

Ky grup, pastaj, urdhëron dhe ndalon duke besuar se ata janë në bindje ndaj Allahut te’ala kurse në realitet ata janë shkelësit e kufijve të Tij. Në këtë mënyrë, shumë nga grupet e shmangura dhe të humbura e konsideronin veten si urdhërues të së mirës dhe ndalues të së keqes, siç janë hauarixhët, mu’tezile, dhe rafidhat (Shi’ajt), dhe të tjerë prej atyre që gabuan në të kuptuarit atë që Allahu u dha atyre me anë të urdhërimit për të mirën dhe ndalimit prej të keqes, xhihadit luftues, dhe çështjeve të tjera. Prishja e shkaktuar nga ky lloj i urdhërimit dhe ndalimit, është shumë më i madh se çfarëdo e mirë që mund të rezultojë.

## KRYENGRITJA KUNDËR IMAMIT TË MUSLIMANËVE

Për këtë arsye, Pejgamberi na urdhëroi që të jemi të durueshëm kur ka padrejtësi nga ana e sunduesit të Muslimanëve, dhe na ndaloi që të luftojmë kundër tij, përderisa ata falen, dhe ai tha:

“Jepuni atyre atë që u takon atyre, dhe luteni Allahun për atë që ju takon.” (Muslimi dhe të tjerët)

Kështu, njëra prej parimeve fundamentale të Ehl es-Sune ue el-Xhemat është besnikëria ndaj grupit të madh të Umetit Musliman, mosrrebelimi kundër sunduesit të tij, dhe shmangia prej betejave kur të paraqiten kaosi dhe fitneja (çrregullimi).

Për sa u përket grupeve e shmangura siç është mu'tezile, ata e konsiderojnë luftimin kundër Imamëve të Muslimanëve si një rën prej parimeve të fesë së tyre. “Teuhidi” – që në terminologjinë e tyre do të thotë mohimi i të gjithë emrave dhe cilësive të Allahut, Drejtësia Hyjnore – që do të thotë mohimi i paracaktimit të Allahut në të gjitha gjërat, pozita në mes dy pozitave – d.m.th. teoria e gabuar e tyre se çdonjëri që mëkaton nuk është më besimtar dhe nuk është krejtësisht jobesimtar, ai është i ngjitur diku në mes, zbatimi i kërcënimeve – duke i marrë në kuptimin e plotë të fjalës dënimet të cilat Allahu i lidh me mëkate të ndryshme në Kur'an, dhe urdhërimi për të mirën dhe ndalimi prej të keqes – pjesë e teorisë së tyre këtu është lufta kundër Imamëve të Muslimanëve.

## **PARIMI I PËRGJITHSHËM I URDHËRIMIT DHE NDALIMIT**

E tërë ajo që jemi duke thënë vjen nën parimin e përgjithshëm i cili thotë se dobia dhe dëmi janë të përziera së bashku, dhe kur duhet zgjedhur në mes të bërjes së një të mire me disa efekte të këqija anësore, apo lënies së asaj të mire që t'i shmanget efekteve të këqija të saja, është e detyrueshme që të zgjidhet kursi i cili ka dobi të përgjithshme apo përfundimtare. Kjo sepse urdhërimi dhe ndalimi ndonëse ato detyrimisht nënkuptojnë arritjen e dobisë dhe parandalimin e së keqes, e kundërta e saj po ashtu duhet të merret në konsideratë. Nëse, në zbatimin e këtij urdhërimi apo ndalimi, ka më shumë dobi të humbur sesa dobi të fituar, apo bëhet dëm më i madh sesa dëmi të cilit i është shmangur, atëherë kjo s'është pjesë e asaj për të cilën Allahu na ka urdhëruar. Madje, kjo është haram për shkak të faktit se dëmi përfundimtar i tij është më i madh sesa dobia e tij.

## **ËSHTË E DETYRUESHME QË TË GJITHA GJËRAT TË VLERËSOHEN SIPAS KRITERIT TË SHERIATIT**

Kriteri i vetëm për vlerësimin e dëmit dhe dobisë së lartpërmendur është peshorja e Sheriatit. Kurdo që ka mundësi të pasohet teksti drejtpërdrejt, s'është e lejuar që të kërkohet gjetiu. Nëse s'mund të gjendet teksti për problemin i cili e konfronton atë, ai mund të bëjë përpjekje me mendjen e tij që ta kuptojë vendimin me anë të analogjisë. Të rralla janë tekstet legale për të cilat askush nuk di se çfarë nënkuptojnë ato, dhe si e tregojnë rrugën ato në vendimet e sheriatit.

Kështu, nëse një individ apo grup vazhdimisht përzien diçka të mirë me diçka tjetër të keqe, dhe nuk e bën njërën pa tjetrën, dhe as që do t'i bëjë të dyja së bashku, apo asnjërën prej tyre, atëherë s'është e lejuar që të urdhërohen ata për të mirën e as të ndalohen prej të keqes. Së pari, çështja duhet të analizohet: nëse e mira e përfshirë është më e madhe, atëherë ata duhet të urdhërohen që ta bëjnë këtë, edhe nëse kjo sjell me vete të keqen e cila është e një shkalle të ulët, dhe ata s'duhet ta ndalojnë të keqen e përfshirë që do të kishte për pasojë humbjen e së mirës e cila është më e madhe se ajo (e keqe). Në të vërtetë, ndalimi i këtillë në një situatë të tillë do të ishte pjesë e bllokimit të rrugës së Allahut (saddun en sebili'lah) dhe do të ishte përpjekje për çrrënjosjen e dëgjueshmërisë ndaj Allahut dhe Pejgamberit të Tij (salallahu alejhi ue selam)

dhe drejt eliminimit të bamirësisë.

Në anën tjetër, nëse e keqja e përfshirë është më e madhe, ajo duhet të ndalohet, edhe nëse kjo sjell me vete humbjen e një të mire e cila është e një shkalle të ulët. Në rastin e këtillë, urdhërimi i kësaj të mire e cila sjell me vete një të keqe të një shkalle të lartë në fakt është urdhërim për të keqen, dhe përpjekje në rrugën e mosbindjes ndaj Allahut dhe Pejgamberit të Tij (salallahu alejhi ue selam).

Nëse e mira dhe e keqja të cilat s'mund të ndahen janë të shkallës së njëjtë, të dyja këto as nuk duhet të urdhërohen e as të ndalohen. Kështu, në rastin kur një e keqe dhe një e mirë s'mund të ndahen, nganjëherë ajo që kërkohet është urdhërimi i së mirës, dhe nganjëherë ndalimi prej të keqes, dhe nganjëherë as ajo e as kjo. Kjo nuk është rregull e përgjithshme dhe aplikohet vetëm në situatat specifike të llojit që i përmendëm.

Për sa i përket rastit të përgjithshëm, e mira duhet të urdhërohet absolutisht, dhe e keqja të ndalohet absolutisht. Për ndonjë individ apo grup specifik, e mira e saj duhet të urdhërohet, dhe e keqja e saj të ndalohet; aspektet e saja të lavdërueshme të lavdërohen, dhe aspektet e saja të dënueshme të kritikohen në atë mënyrë që urdhërimi i të mirës nuk përfshin humbjen e së mirës më të madhe se vetë ajo e mirë e as shkaktimin e një të keqeje të shkallës së lartë, dhe ndalimi i së keqes nuk përfshin shkaktimin e të keqes më të madhe apo humbjes së një të mire të një shkalle të lartë.

Kur kjo çështje është e paqartë, besimtari duhet të përpiqet që ta kuptojë atë derisa t'i bëhet e qartë e vërteta atij. Ai s'mund të ndërmer akte të dëgjueshmërisë, përveç se me dituri dhe qëllim të pastër. Nëse ai dështon në këtë, ai është në mosbindje ndaj Allahut. Lënia pas dore e asaj që është e detyrueshme është mosbindje mu ashtu siç të bërit e asaj që është e ndaluar në fushën e urdhërimit për të mirën po ashtu është mosbindje. Kjo është një fushë mjaft e gjerë dhe e rrezikshme, dhe nuk ka fuqi as mundësi përveç me ndihmën e Allahut!

Shembull i kësaj çështje në Sunet është lënia e Pejgamberit (salallahu alejhi ue selam) Abdullah ibn Ubej ibn Selulin dhe të tjerët sikur ai nga mesi i udhëheqësve të hipokrizisë dhe çoroditjes, për shkak të ndihmësve të shumtë të tyre dhe njerëzve besnik ndaj tyre. Mënjanimi i së keqes së tyre përmes dënimit, do të sillte mënjanimin e një të mire tjetër të shkallës më të lartë, për shkak të hidhërimit të fisit të tij dhe zgjimit të armiqësisë fisnore të tyre kundër Pejgamberit dhe Muslimanëve. Po ashtu, kjo do të rezultonte në neveritjen e njerëzve, kur ata do të kishin dëgjuar se Pejgamberi i vret shoqëruesit e tij. Kështu, kur ai përhap në mesin e njerëzve atë që përhap si ofendim ndaj A'ishes (Allahu qoftë i kënaqur me të) dhe pastaj e mohoi atë, dhe kur Sa'ad ibn Mu'adh i foli atij me ashpërsi ashtu siç e meritoi dhe tregoi në hipokrizinë e tij, dhe pastaj Sa'ad ibn Ubade – ndonëse ai ishte besimtar dhe shoqërues e njeri i drejtë – bëri thirrje për mbrojtjen e tij, që Abdullah ibn Ubej të lihet i qetë, fisi i secilit nga këta dy njerëz u betua për besnikëri ndaj pozitës së anëtarit të fisit të tyre, derisa gati rezultuan kaosi dhe gjakderdhja.

## **DASHURIA NDAJ TË MIRËS DUHET TË JETË NË HARMONI ME ATË ÇKA DO ALLAHU**

Ky parim është ai se dashuria e besimtarit për atë që është e mirë, dhe urrejtja e tij për atë që është e keqe, dhe dëshirat e tija për kryerjen e së mirës dhe dëshira e tij për shmangien dhe parandalimin e së keqes duhet të jenë në harmoni me atë çka Allahu do dhe urren. Allahu e do tërë atë që na e ka urdhëruar neve në shariatën e Tij, dhe nuk e pëlqen tërë atë që Ai na e ka ndaluar në shariatën e Tij. Për më tepër, vepra e besimtarit në atë të cilën ai e do (të mirën), dhe shmangia dhe kundërshtimi ndaj asaj të cilën ai e urren (të keqen), duhet të jetë sipas shtrirjes së mundësive dhe forcës së tij, se vërtet, Allahu nuk kërkon nga ndonjëri prej nesh asnjë gjë më shumë se atë që është brenda mundësive tona. Allahu thotë:

Kini frikë Allahun aq sa keni mundësi. (Kur'an 64:16).

## **DASHURIA DHE URREJTJA E ZEMRËS**

Ajo që i takon besimtarit shprehur në veprat e tija nuk duhet të ngatërrohet me detyrat e tija që shprehen me vepra të zemrës. Është e detyrueshme për besimtarin që urrejtja e tij e së keqes dhe dashuria e tij ndaj të mirës, dhe dëshira e tij që të bëjë mirë dhe dëshira e tij që të

kundërshtojë dhe largojë të keqen të jetë e përsosur, e plotë, dhe pa dyshim apo ngurrim. Çfarëdo mangësie në këtë fushë s'është tjetër veçse mangësi në besim (iman). Kjo është në kontrast me veprat e trupit të tij, të cilat janë vetëm brenda kufijve të mundësisë së tij.

Kur vullneti i zemrës, pëlqimet dhe mospëlqimet e saja të janë të plota dhe të përsosura (në harmoni me dashurinë dhe urrejtjen e Allahut) dhe pastaj besimtari të bëjë tërë atë që është brenda mundësive të tij, atij do t'i jepet shpërblimi i atij i cili zbaton urdhrat e Allahut përsosurisht. Disa nga njerëzit kanë dashuri dhe urrejtje, të cilat s'janë në harmoni me dashurinë e Allahut dhe Pejgamberit të Tij dhe urrejtjet e Allahut dhe Pejgamberit të Tij, dhe kjo është lloj i hua (prirje, epsh, apo tendencë e unit). Nëse ai i pason ato, ai është pasues i epshit. Allahu ka thënë:

Dhe kush është më i shmangur se ai që e pason epshin pa ndonjë udhëzim prej Allahut? (Kur'an 28:50)

Origjina e epshit është ajo të cilën e do uni, dhe ajo të cilën uni e urren është rezultat i saj.



## ÇFARË DO TË THOTË SAKTËSISHT EPSH (HAUAA)

Domethënia e haua-së është dashuria dhe urrejtja e cila është në unin. Kjo s'është në dhe jashtë vetvetes e dënueshme, meqë s'është nën kontrollin e njeriut. Më saktë, ajo që është e dënueshme është pasimi i këtyre dëshirave, pëlqimeve dhe urrejtjeve. Allahu i tha Daudit:

O Daud, Ne të kemi bërë mëkëmbës në tokë. Pra sundo mes njerëzve me të vërtetën, dhe mos e paso epshin (haua) e të shmangesh nga rruga e Allahut. (Kur'an 38:26)

Dhe Allahu thotë në një tjetër ajet:

Dhe kush është më i shmangur se ai që pason epshin e tij pa ndonjë udhëzim prej Allahut? (Kur'an 28:50)

Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) na rrëfen në hadith:

“Tri gjëra janë që shpëtojnë: frika ndaj Allahut në publik dhe privatisht, matura në varfëri dhe në pasuri, dhe të folurit e së vërtetës në hidhërim dhe në kënaqësi. Dhe janë tri gjëra të cilat çojnë në shkatërrim: bindja ndaj lakmisë, pasimi i epshit, dhe të qenit i kënaqur me vetveten.”

Dashuria dhe urrejtja për të cilat jemi duke folur sjellin “shije” të caktuara, ndjenja dhe dëshira në prani të gjërave të dashura apo të urryera. Kushdo që pason këto dëshira dhe ndjenja pa urdhër prej Allahut dhe Pejgamberit të Tij, është ai i cili përshkruhet si pasues i këtij epshi. Në të

vërtetë, kjo madje mund të arrijë nivelin e shirkut ku ai e merr për zot epshin e tij! (Shiko Kur'anin 43:25)

## **PASIMI I EPSHIT NË FETË E MËPARSHME**

Pasimi i epshit në çështjet që i takojnë fesë dhe adhurimit, është më e rëndë dhe më serioze se pasimi i epshit në çështjet e dëshirave të rëndomta të kësaj bote. E para prej këtyre është gjendja e atyre të cilët u bënë jobesimtarë prej Krishterëve, Çifutëve dhe idhujtarëve, siç ka thënë Allahu për ta:

Dhe kështu, nëse ata nuk i përgjigjen thirrjes tënde, dije se ata vetëm pasojnë epshin e tyre, dhe kush është më i shmangur se ai i cili pason epshin e vet pa ndonjë udhëzim prej Allahut, dhe Allahu nuk i udhëzon ata që shtypin. (Kur'an 28:50)

Dhe, në një tjetër ajet, Allahu thotë:

Allahu ju jep një shembull prej vetëve tuaja: A keni ju prej atyre të cilët dora juaj e djathtë i posedon (d.m.th. robër) ndonjë ortak në atë që Allahu ju ka dhënë, ashtu që ata të jenë të barabartë me ju. Ju u frikësoheni atyre ashtu siç i frikësoheni njëri-tjetrit. Kështu, Ne i shpjegojmë shenjat një populli i cili kupton. Jo, ata që bëjnë padrejtësi e pasojnë epshin e tyre pa dituri. Atëherë, kush do ta udhëzojë atë që Allahu e humb, dhe ata nuk kanë ndihmës. (Kur'an 30:28-29)

Dhe Allahu thotë në një ajet tjetër:

Allahu ka sqaruar për ju atë që ju është ndaluar në çdo gjë, përveç rasteve të domosdoshmërisë absolute. Vërtet, njerëzit shmangen përmes pasimit të epshit të vet dhe pa ndonjë dituri, dhe vërtet Allahu është më i dijsmi për përdhunuesit. (Kur'an 6:119)

Dhe, në një tjetër ajet, Allahu ka thënë:

Thuaj: O njerëzit e Librit, mos prezantoni në fenë tuaj skajshmëri të cilat s'janë prej të vërtetës. Dhe mos e pasoni epshin e njerëzve të cilët tashmë janë shmang. Ata i kanë humbur shumë njerëz, dhe vetë janë shmang prej rrugës së drejtë. (Kur'an 5:77)

Dhe, Allahu ka thënë:

Çifutët dhe Krishterët kurrë s'do të jenë të kënaqur me ju derisa t'i pasoni traditat dhe rrugët e tyre. Thuaj: vërtet, udhëzimi i Allahut është udhëzim i vërtetë. Dhe nëse ti i pason epshet e tyre pasi që të ka ardhur dituria, s'do të kesh ndonjë mbrojtës e as ndihmës kundër Allahut. (Kur'an 2:120).

Dhe, përsëri në Suren Bekare, Allahu thotë:

Dhe nëse ti i pason epshet e tyre pas diturisë e cila të ka ardhur ty, vërtet, do të jesh prej tiranëve. (Kur'an 2:145).

Allahu thotë:

Dhe gjyko në mes tyre me atë që Allahu ka zbritur, dhe mos i paso epshet e tyre dhe ruaju prej tyre se mos po të joshin (e të largojnë) nga diçka prej asaj që Allahu ta ka zbritur ty. (Kur'an 5:49)

Kushdo që del jashtë diktateve të Kur'anit dhe Sunetit – nga mesi i atyre që quhen “dijetarë” apo “adhurues”, ata janë të njohur si njerëzit e epshit, mu ashtu siç selefi, Allahu i mëshiroftë, iu referoheshin atyre si Ehlu-l-Haua, d.m.th. pasuesit e epshit.

Kjo sepse kushdo që nuk e ka pasuar diturinë, ai e ka pasuar epshin e tij. Për më tepër, dituria për fenë nuk vjen ndryshe, përveç përmes udhëzimit të Allahut me të cilën Ai e dërgoi Pejgamberin e Tij (salallahu alejhi ue selam). Kështu, Allahu ka thënë:

Vërtet, shumë prej tyre shmangen duke pasuar epshin e vet dhe pa ndonjë dituri

(Kur'an 6:119).

Allahu tha në një vend tjetër:

Kush është më i humbur se ai i cili pason epshin e vet pa ndonjë udhëzim prej Allahut. (Kur'an 28:50).

## **ATË QË PERSONI E DO DHE URREN DUHET TË JETË NË PAJTIM ME URDHËRIN E ALLAHUT DHE PEJGAMBERIT TË TIJ**

*(salallahu alejhi ue selam)*

Është e detyrueshme për çdo rob të Allahut që të shikojë për së afërmi në dashuritë dhe urrejtjet e tija apo saja, dhe në intensitetin e dashurisë së tij për atë të cilën e do dhe urrejtjen e tij ndaj asaj të cilën e urren, se a është kjo në harmoni me urdhrin e Allahut dhe Pejgamberit të Tij? Ky pra është udhëzimi i Allahut të cilin Ai e zbriti në Pejgamberin e Tij, ashtu që ai që urdhëruar të ketë këto dashuri dhe urrejtje. Në këtë mënyrë, robi i Allahut do t'i shmanget asaj që ta vendosë veten para Allahut dhe Pejgamberit (salallahu alejhi ue selam), sepse Allahu ka thënë:

**O ju që besoni, mos vendosni (ndonjë gjë) para Allahut dhe Pejgamberit të Tij.** (Kur'an 49:1) d.m.th. Mos vendosni për pozitën tuaj në ndonjë vepër apo çështje pa e ditur së pari pozitën e Allahut dhe Pejgamberit të Tij ndaj saj.

Cilido që do dhe urren para se Allahu dhe Pejgamberi i Tij ta kenë urdhëruar që të veprojnë ashtu, ai ka hyrë në fushën e vendosjes së diçkaje para Allahut dhe Pejgamberit të Tij (salallahu alejhi ue selam). Dashuritë dhe urrejtjet e thjeshta janë epshe, por epsi i cili është i ndaluar për Muslimanin është pasimi i këtyre prirjeve pa udhëzimin e Allahut. Për këtë Allahu i tha Pejgamberit të Tij:

Dhe mos paso epshin tënd se do të shmangesh nga rruga e Allahut. Ata që shmangen nga rruga e Allahut i pret një dënim i tmerrshëm. (Kur'an 38:26)

Këtu Allahu na informon se pasimi i epshit e shmang personin nga rruga e Allahut. Rruga e Allahut është udhëzim dhe program me të cilin Ai i dërgoi Pejgamberët e Tij (salallahu alejhi ue selam), dhe kjo është rruga që çon te Allahu.

## ÇKA JANË “PUNËT E MIRA”?

Në analizën e fundit, urdhërimi për të mirën dhe ndalimi i së keqes është njëra prej veprave më të detyrueshme dhe njëra prej akteve më të mira dhe më të lavdërueshme. Allahu ka thënë:

Dhe Ai do t'ju sprovtojë se cilët prej jush janë më të mirët në vepra. (Kur'an 67:2).

El-Fadhil ibn Ijad (Dijetar i madh i Mekës i shekullit të dytë) tha për “veprat e mira” të përmendura në këtë ajet:

“(d.m.th.) Më të sinqertat dhe më korrektet. Vërtet, çfarëdo vepre e cila bëhet me sinqeritet të plotë por s'është korrekte, ajo është e refuzuar, dhe nëse ajo është plotësisht korrekte por nuk bëhet me sinqeritet të plotë, ajo është e refuzuar. Vetëm ajo e cila bëhet me sinqeritet të plotë dhe korrektësi sipas ligjit të Allahut është e pranueshme. Vepra e sinqertë është ajo e cila bëhet krejtësisht për hir të Allahut, dhe vepra korrekte ajo që është sipas traditës (Sunetit).”

Është kërkesë e veprave të mira që ato të bëhen vetëm për Fytyrën e Allahut, sepse Allahu nuk pranon ndonjë vepër përveç atyre me të cilat është kërkuar vetëm Fytyra e Tij. Kjo është në hadithin sahi të transmetuar nga Ebu Hurejre se Pejgamberi ka thënë:

“Allahu i Lartësuar thotë: Unë jam ortakë që nuk ka nevojë për ndonjë ortak. Kurdo që ndokush bën ndonjë vepër, pjesërisht për Mua dhe pjesërisht për një ortak të

imagjinuar, Unë plotësisht jam i lirë nga ajo vepër, dhe ajo është e tëra për ortakun i cili më është shoqëruar.”

Kjo është esenca e Teuhidit i cili është bazë e Islamit. Është dini (feja) i Allahut me të cilin Ai i dërgoi të gjithë Pejgamberët. Për hir të Tij, Ai e krijoi krijimin, dhe kjo është e drejta e Tij ndaj të gjithë robërve të Tij; që ata ta adhurojnë vetëm Atë, dhe të mos shoqërojnë asgjë me Të.

Veprat e mira të cilat Allahu dhe Pejgamberi i Tij i kanë urdhëruar janë thjesht bindje. Çdo akt i bindjes është vepër e mirë, dhe është punë e diktuar nga sheriatit dhe Suneti. Ato janë çdo gjë që na është urdhëruar neve, qoftë si detyra apo akte të rekomanduara. Këto pra janë veprat e mira (el-amel es-salih), dhe është ajo që është e mirë (hassan), dhe është drejtësi/ndershmëri (el-Birr), dhe është tërë ajo që është e mirë (el-Khair). E kundërta e saj është mosbindje (Me’sije), vepër e çoroditur (el-amel el-fasid), vepra të këqija (es-Seji’at), rebelim (el-fuxhur), shtypje (edh-dhulm), dhe shkelje (el-begiu).

Çdo vepër duhet të përmbajë dy gjëra: qëllimin, dhe lëvizjen (veprën). Kështu, Pejgamberi ka thënë:

“Emrat më të vërtetë janë Harith (d.m.th. ai i cili e lëron tokën) dhe Hammam (ai i cili përherë parashtron pikësynime dhe kërkon përmbushjen e tyre).”

Çdonjëri është lëruës dhe kërkues i pikësynimeve, ai ka veprat dhe qëllimet. Sidoqoftë, qëllimi i vetëm i lavdërueshëm të cilin Allahu e pranon dhe për të cilin shpërblen, është qëllimi i bërjes së veprës vetëm për hir të Allahut.



Vepra e lavdërueshme është vepra e mirë, dhe është vepra në të cilën jemi urdhëruar. Për këtë arsye, Umer ibn el-Hattab thoshte ne lutjen e tij:

“O Allah, bëji të gjitha veprat e mia të mira, dhe bëni ato vetëm për Fytyrën tënde, dhe mos bëj që të këtë pjesë në të ndokush tjetër.”

Duke qenë se ky është rasti me të gjitha veprat e mira, po ashtu është edhe për urdhërimin për të mirën dhe ndalimin prej të keqes, dhe është e domosdoshme për këtë që të jetë kështu (d.m.th. akti i urdhërimit dhe ndalimit duhet të jetë i mirë dhe i lavdërueshëm, i cili siç kemi parë do të thotë të jetë korrekt dhe vetëm për hir të Allahut, është bindje ndaj Allahut, dhe nuk bëhet për ndonjë motiv të mëvonshëm.) Kjo është referencë ndaj atij i cili urdhëron dhe ndalon të tjerët.

## **VEPRA S'ËSHTË E MUNDUR, PËRVEÇ ME DITURI DHE TË KUPTUAR**

Nuk mund të ketë vepër të mirë në mungesë të diturisë ('ilm) dhe të kuptuar të ligjit (fikh), siç Umer ibn Abdul-Aziz (nipi i Umer ibn el-Hattab, dhe Halife i drejtë) thoshte:

“Kushdo që e adhuron Allahun pa dituri, më shumë çrregullon sesa që përfiton.” Dhe, si në thënien e Muadh ibn Xhebelit (shoqërues i Pejgamberit):

“Dituria është Imam i veprës, dhe vepra është rezultat i saj.”

Kjo është e dukshme: qëllimet dhe veprat të cilat s'janë të bazuara në dituri janë injorancë dhe shmangie, dhe pasimi i epshit, siç kemi thënë më parë. Ky është dallimi në mes njerëzve të Xhahilijetit dhe njerëzve të Islamit. Kështu, dituria për të mirën (Ma'ruf) dhe të keqen (Munker) janë nevoja absolute, siç është aftësia për të dalluar në mes tyre.

Dhe dituria për gjendjen e atyre që do të urdhërohen dhe ndalohen po ashtu është me rëndësi.

Për dobi optimale, urdhërimi për të mirën duhet të ekzekutohet në Rrugën e Drejtë. Rruga e Drejtë është shtegu më i shkurtër, dhe ajo që çon në arritjen e qëllimit të kërkuar.

## **NË URDHËRIMIN PËR TË MIRËN LIPSEN BUTËSIA, DURIMI DHE VETËPËRMBAJTJA**

Këto gjëra duhet të bëhen me butësi. Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) ka thënë:

“Nuk hyn butësia në ndonjë gjë e që mos ta zbukurojë atë, dhe nuk largohet nga ndonjë gjë e që mos ta shëmtojë atë.” (Muslimi dhe të tjerët).

Dhe, ai (salallahu alejhi ue selam) ka thënë:

“Oj A’ishe: Vërtet, Allahu është i Butë dhe Ai e do butësinë. Ai ka bërë që ajo e cila arrihet me butësi të mos arrihet me forcë apo me çfarëdo qoftë tjetër.” (Muslimi dhe të tjerët)

Në të njëjtën kohë, praktikuesi i urdhërimit për të mirën dhe ndalimit prej të keqes duhet të jetë i vetëpërmbajtur dhe durimtar kur të përballet me fatkeqësi dhe persekutim. Persekutimi duhet, prej domosdoshmërisë, ta konfrontojë praktikuesin e vërtetë të urdhërimit për të mirën. Nëse ai s’është durimtar, i vetëpërmbajtur dhe i urtë para kësaj, ai më shumë do të shkaktojë çrregullim se reformë. Allahu na tregon për thëniet e Llukmanit të birit të tij:

Urdhëro për të mirën dhe ndalo prej të keqes, dhe bëhu i durueshëm kur të godet ndonjë vuajtje; vërtet, kjo është pozita më drejtë. (Kur’an 31:17).

Kështu, Allahu i urdhëroi Pejgamberët e Tij, dhe ata janë imamët e urdhërimit për të mirën dhe ndalimit prej të keqes, që të kenë durim, mu ashtu siç Ai e urdhëroi vulën e Pejgamberëve, Muhamedin (salallahu alejhi ue selam). Urdhri që të kihet durim erdhi së bashku me urdhrin që të shpërndahet porosia e Islamit. Kur Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) së pari qe urdhëruar që ta përhapë porosinë tek njerëzit, Allahu e dërgoi Suren el-Mudethir, e cila pasoi pas shpalljes së pesë ajeteve të Sures Ikre' e cila shpalli fillimin e pejgamberllëkut. Allahu tha në el-Mudethir:

O ti i mbuluar\* Ngrihu dhe paralajmëro\* Dhe lavdëro madhësitinë e Zotit tënd\* Dhe pastro rrobat tua\* Dhe largohu nga zotat e rrejshëm dhe forma të tjera të marrëzisë\*

Dhe mos e bën këtë duke shpresuar në përfitim\* Dhe për hir të Zotit tënd duro.

(Kur'an 74:1-7).

Allahu i filloi këto shtatë ajete, me të cilat Ai e mandatoi Pejgamberin (salallahu alejhi ue selam) që ta shpërndajë porosinë te krijimi i Tij, duke e urdhëruar Pejgamberin që të paralajmërojë, dhe i përmylli ato me urdhrin që të ketë durim. Paralajmërimi i njerëzve që të kenë durim, natyrisht është urdhërimi i tyre që të bëjnë mirë dhe ndalimi i tyre prej të bërit keq, pra, ne shohim se durimi është i detyrueshëm pasi që të angazhohemi në urdhërimin e së mirës. Në këtë gjendje, Allahu thotë:

Dhe bëhu i durueshëm ndaj paracaktimit të Zotit tënd. Vërtet ti je i mbikëqyrur. (Kur'an 52:48)

Dhe bëhu i durueshëm ndaj asaj çka thonë ata, dhe largohu prej tyre në mënyrë dinjitoze. (Kur'an 73:10)

Dhe bëhu i durueshëm, ashtu siç qenë të durueshëm pejgamberët e qëndrueshëm. (Kur'an 46:35).

Pra, bëhu i durueshëm ndaj paracaktimit të Zotit tënd, dhe mos u bë sikur ai në barkun e Balenës (Junusi) (Kur'an 68:48)

Dhe bëhu i durueshëm, dhe durimi yt s'është tjetër pos me lejen e Allahut. (Kur'an 16:127).

Dhe duro, meqë vërtet Allahu nuk e humb shpërblimin e bamirësve. (Kur'an 11:115).

Kështu, tri gjëra janë absolutisht esenciale: dituria, butësia, dhe durimi. Dituria kërkohet para urdhërimit për të mirën dhe ndalimit prej të keqes, butësia kërkohet gjatë praktikimit të saj, dhe durimi kërkohet pas kësaj. Kjo ndarje s'është që të mohohet fakti se këto tri cilësi duhet të jenë të pranishme gjatë gjithë kohës. Kjo është e ngjashme me thënien e transmetuar nga gjeneratat e mëhershme të dijetarëve dhe e cila nga disa i është atribuar pejgamberëve. Ebu Jala përmendi në librin e tij të titulluar el-Mu'temed siç vijon:

“Askush s'duhet të urdhërojë dhe të ndalojë përveç atij i cili është i ditur në atë që ai urdhëron, i ditur në atë që ndalon, i butë në atë që e ndalon, i vetëpërmbajtur në atë që urdhëron, dhe i vetëpërmbajtur në atë ndalon.”

## VËSHTRËSIA E KËTYRE KËRKESAVE

Mos gaboni në lidhje me këtë, këto kërkesa të urdhërimit dhe ndalimit paraqesin një shkallë të lartë të vështirësisë në situata për shumë njerëz. Kështu, disa mendojnë se detyra është shkarkuar nga supet e tyre për shkak të disa mangësive në parakushtet e saja, dhe kështu ai e lë pas dore këtë. Kjo mund ta dëmtojë më shumë atë se që do të ishte dëmtuar nga urdhërimi dhe ndalimi përkundër mangësive të tija në një apo në më shumë nga këto parakushte, apo kjo mund ta dëmtojë atë më pak. Dështimi që të zbatohet detyra e urdhërimit për të mirën është mosbindje ndaj Allahut, dhe bërja e asaj që Allahu ka ndaluar në këtë po ashtu është mosbindje. Ai që ikë prej një akti të mosbindjes në tjetrin është sikurse ai që kërkon strehim nga tiganisja duke kërcyer në zjarr, apo sikur ai që ikë nga një fe e rrejshme në tjetrën, ku e dyta mund të jetë më e keqe sesa e para, apo ajo mund të jetë më pak e keqe, dhe ato mund të jenë barabar të këqija. Kjo është e njëjtë në rastin e atij që e neglizhon detyrën e tij për të mirën dhe ndalimin e së keqes dhe ai i cili e praktikon urdhërimin për të mirë, por shkelë (mëkaton) dhe nuk i bindet Allahut në këtë. Mëkati i të parës mund të jetë më i madh se i të dytës, apo i të dytës mund të jetë më i madh se i të parës, apo ato mund të jenë barabar të mëdha.

## **MOSBINDJA NDAJ ALLAHUT SHKAKTON VËSHIRËSI, BINDJA SHKAKTON LEHTËSIM**

Një gjë e cila qartë është vendosur prej shenjave të Allahut e cila na është treguar në mes të horizonteve dhe në vetat tona, dhe me të cilën Ai ka dëshmuar në Librin e Tij - është ajo se mosbindja shkakton fatkeqësi dhe vështirësi. E keqja e fatkeqësive dhe e dënimeve vjen nga e keqja e veprave të njeriut. Po ashtu, bindja është shkak për bollëk dhe rehati. Bamirësia ndaj robërve është shkak për bamirësinë nga ana e Allahut atij. Allahu ka thënë:

Dhe çfarëdo fatkeqësie që ju godet, ajo është për shkak të veprave tuaja (të këqija) – dhe Allahu jep shumë. (Kur'an 42:30)

Çfarëdo e mire që ju vjen është prej Allahut, dhe çfarëdo e keqe që të godet është nga vetë ti. (Kur'an 4:79)

Vërtet, ata prej jush të cilët e kthyen shpinën në ditën kur dy ushtritë u takuan, Shejtani i bëri ata që të rrëshqasin për shkak të asaj që vepruan. Allahu ua ka falur atyre. (Kur'an 3:155)

Pra, a është ajo se kur ju godet ndonjë fatkeqësi (në luftë), ndonëse ju më herët u keni shkakuar dëm dy herë më të madh, ju pyetni: Prej nga kjo? Thuaj: Kjo është nga vetë ju. (Kur'an 3:165).

Apo Ai mund t'i bëjë që të ndalen të gjitha (d.m.th. anijet në det) për shkak të asaj që ata vepruan, dhe Ai fal shumë. (Kur'an 42:34)

Dhe nëse ata i godet ndonjë fatkeqësi për shkak të asaj që vepruan, vërtet njeriu është përbuzës, i pa besë. (Kur'an 42:48)

Allahu s'do t'i dënojë ata derisa ti je në mesin e tyre, dhe Ai s'do t'i dënojë ata derisa ata (disa prej tyre) kërkojnë falje. (Kur'an 8:33)



## DËNIMI I POPUJVE TË MËPARSHËM NGA ALLAHU PËR SHKAK TË MOSBINDJES SË TYRE

Allahu na ka informuar për dënimin e Tij të popujve të mëhershëm për shkak të ligësisë së tyre, siç ishin populli i Nuhut, Adit, Themudit, popullin e Lutit, njerëzit e qytetit të Medjenit, popullin e Firaunit (Faraonit) në këtë botë, dhe Ai na ka informuar për dënimin që i pret ata në botën tjetër. Kështu, besimtari i cili e kishte fshehur besimin e tij nga populli i Firaunit tha, Allahu na tregon në Kur'an:

O populli im, vërtet unë frikësohem për ju nga diçka sikur ditët e popujve të cilët erdhën para jush, diçka sikur dënimi i cili e goditi popullin e Nuhut, Adit, Themudit, dhe atyre që erdhën pas tyre. Allahu nuk ka për qëllim shtypjen e robërve të Tij. O populli im, vërtet unë frikësohem për ju për ditën e thirrjes së njëri-tjetrit. Në atë ditë ju do ta ktheni shpinën dhe do të ikni të frikësuar, dhe s'do të ketë asnjë që do të mund t'ju mbrojë prej Allahut. Atë që Allahu e humb, askush s'mund ta udhëzojë. (Kur'an 40:30-33)

Dhe Allahu tha në një tjetër ajet në lidhje me dënimin në këtë botë:

I këtyllë është dënimi, ndërsa dënimi në botën tjetër është më i madh. Vetëm sikur ta dinit. (Kur'an 68:33)

Ne do t'i dënojmë ata dy herë, dhe pastaj ata do të kthehen në një dënim të madh.

(Kur'an 9:101).

Ne do t'i bëjmë që të shijojnë dënimin e vogël para dënimit të madh, ashtu që ata të kthehen (në atë që është e mirë) (Kur'an 32:21)

Pra, ruaje ditën kur qielli do të bëhet me një tym të dallueshëm\* Ai i kaplon njerëzit; ky është një dënim i dhimbshëm\* O Zoti ynë! Na e largo këtë dënim. Vërtet, ne jemi besimtarë.\* Si do t'i bëjë ajo (largimi i dënimit të tyre) që të përkujtojnë dhe besojnë kur tashmë i Dërguari u ka ardhur atyre me shenja të qarta?\* Dhe ata ia kthyen shpinën atij duke thënë: "... i mësuar nga të tjerët" dhe "...i xhindosur".\* Vërtet, Ne do ta largojmë pak dënimin prej tyre, dhe vërtet, ata prapë do të kthehen.\* Në ditën kur Ne do ta japim goditjen më të fortë. Vërtet, hakmarrja jonë do të jetë e plotë. (Kur'an 44:10-16)

## DËNIMI I KEQBËRËSVE NË KËTË BOTË DHE NË TJETRËN

Kështu, në shumë ajete të cilat përmbajnë paralajmërimet për ata që nuk i binden Allahut, Allahu e përmend dënimin e Tij të keqbërësve në këtë botë si dhe dënimin të cilin Ai e ka përgatitur për ta në Jetën e Përtejme. Në ajete të tjera, Ai përmend vetëm dënimin e Jetës së Përtejme, sepse dënimi i saj është shumë më i madh, dhe shpërblimi është shumë më i madh, dhe ai është vend i përhershëm. Pra, kur përmenden dënimet e kësaj bote, ato janë dytësore ndaj përmendjes së Jetës së Përtejme, si në rrefimin vijues të Jusufit (paqja qoftë mbi të):

Në këtë mënyrë Ne e autorizuar Jusufin në tokë; ai lëviz në të kudo që dëshiron. Ne s'do ta mohojmë shpërblimin e atyre që bëjnë mirë, dhe shpërblimi i Jetës së Përtejme është më i mirë për ata që besojnë dhe i frikësohen Allahut. (Kur'an 12:56- 57)

Dhe kështu Allahu u dha atyre shpërblimin e kësaj bote, dhe shpërblimin më të mirë në Jetën e Përtejme. (Kur'an 3:148)

Dhe atyre që migruan për hir të Allahut pasi që qenë shtypur, ne do t'u mundësojmë vendbanim të mirë në tokë, ndërsa shpërblimi i Jetës Tjetër është më i madh, vetëm sikur ta dinin. Ata që kanë durim, dhe plotësisht mbështeten në Zotin e tyre. (Kur'an 16:41-41)

Allahu tha për Ibrahimin (paqja qoftë mbi të) në një ajet tjetër:

Dhe Ne i dhamë atij shpërblimin e tij në këtë jetë, dhe vërtet, ai është në mesin e të mirëve në Jetën e Përtejme. (Kur'an 16:122)

Për sa i përket asaj çka Allahu ka përmendur në lidhje me dënimin e kësaj bote dhe tjetrës, ne mund të shikojmë në suren en-Nazi'at në të cilën Ai tha:

Pasha ata (engjëjt) të cilët heqin dhunshëm (shpirtrat e të këqijve në çastin e vdekjes)\* Dhe pasha ata të cilët nxjerrin me lehtësi (shpirtrat e të mirëve në çastin e vdekjes) (Kur'an 79:1-2)

Dhe pastaj, në suren e njëjtë, Allahu tha:

Në atë ditë kur të ndodhë dridhja dhe lëkundja e madhe (me fyerjen e parë të Surit, gjë që sinjalizon vdekjen e të gjithë krijimit)\* E cila pasohet me një tjetër të ngjashme (fryrja e dytë e Surit, gjë që sinjalizon ringjalljen e tërë krijimit) (Kur'an 79:6-7)

Në të cilin Ai përmendi ditën e Kijametit në përgjithësi, dhe pastaj tha:

A të ka mbërri rrëfimi i Musait?\* Kur Zoti i tij e thirri atë në luginën e shenjtë Tuva\*(duke thënë) Shko te Firauni, se vërtet ai ka tejkalar (kufijtë)\* Dhe thuaj atij: A ke ndërmend që të pastrohesh?\* Dhe se unë të udhëzoj në Zotin tënd ashtu që t'i frikësohesh Atij? Pastaj Musai i tregoi atij një Shenjë të Madhe.\* Por Firauni refuzoi dhe nuk u bind.\* Pastaj, ai u kthye prapa, duke bërë përpjekje

të madhe (kundër së vërtetës).<sup>\*</sup> Pastaj, ai i mblodhi forcat e tija dhe shpalli<sup>\*</sup> Duke thënë: Unë jam zoti juaj më i lartë<sup>\*</sup> Atëherë Allahu e shkatërroi atë, dhe bëri shembull prej tij në Jetën e Përtejme dhe në këtë jetë<sup>\*</sup> Vërtet në këtë ka paralajmërim mësimdhënës për ata që kanë frikë Allahun. (Kur'an 79:15-26)

Pastaj, Allahu përmendi në detaje vendin e fillimit dhe vendin e kthimit duke thënë:

A është më vështirë krijimi juaj apo i qiejve? Allahu i ka ndërtuar ata<sup>\*</sup> Ai ngriti lart kupën qiellore, dhe bëri rend në të dhe e përsosi atë<sup>\*</sup>...<sup>\*</sup> Dhe kështu, kur të arrijë çasti i madh dërrmues (Kijameti)<sup>\*</sup> Në atë ditë, njeriut do t'i kujtohet tërë ajo për çka ai përpiquej<sup>\*</sup> Dhe Zjarri do të jetë qartë i dukshëm për të gjithë ata që shohin<sup>\*</sup> Pastaj, për sa i përket atij që ka tejkalar (kufijtë)<sup>\*</sup> Dhe e preferoi jetën e kësaj bote<sup>\*</sup> Vërtet (për të tillin) zjarri është vendbanim i përhershëm i tij<sup>\*</sup> Dhe për sa u përket atyre që patën frikë për qëndrimin e tyre para Zotit të tyre, dhe ia ndaluan vetes atë që u diktonte epshi i tyre<sup>\*</sup> Vërtet, Kopshti (i Parajsës) është vendbanimi i përhershëm i tyre. (Kur'an 79:27-28, 34-41)

Po ashtu, në suren el-Muzemil, Allahu përmend thënien e vet:

Dhe më lë Mua me ata që mohojnë të vërtetën, të cilët posedojnë gjëra të mira të kësaj bote, dhe mos i trazo ata për një kohë<sup>\*</sup> Vërtet, ne kemi zinxhirë për këmbë (që t'i lidhim ata) dhe zjarr (që t'i djegim ata)<sup>\*</sup> Dhe ushqim që zë frymën, dhe një dënim të dhimbshëm<sup>\*</sup> Një ditë, toka dhe

malet do të dridhen dhe lëkunden, dhe malet do të jenë si një grumbull zalli i derdhur që rrëshqet\* Vërtet, ne ju kemi dërguar Pejgamber si dëshmitar ndaj jush, mu ashtu siç i dërguam Firaunit një Pejgamber\* Por, Firauni nuk iu bind Pejgamberit, andaj Ne i dhamë atij një dënim të rëndë. (Kur'an 73:11-16)

Po ashtu, në suren el-Hakka, Allahu përmend rrëfimet e popujve pabesimtarë, siç është Themudi, Adi, Dhe Firauni, dhe pastaj thotë:

Kur një tingull i vetëm të kumbojë në Sur\* Dhe toka e malet të ngrihen dhe të thërrmohen me një goditje të vetme. (Kur'an 69:13-14)

Pastaj, në ajetin 15-37 Allahu i përshkruan njerëzit e Parajsës dhe Zjarrit, si dhe gjendjen e tyre në ditën e Kijametit dhe më pas.

Në suren el-Kalem, Allahu përmend rrëfimin e poseduesve të kopshtit të cilët komplotuan për t'i ndaluar të drejtat e të varfërve prej tyre dhe qenë dënuar me shkatërrimin e të mbjellave të tyre. Pastaj Allahu thotë:

I tillë është dënimi, ndërsa dënimi i Jetës Tjetër është edhe më i madh. Vetëm sikur ta dinin. (Kur'an 68:33)

Përsëri, në suren et-Tegabun, Allahu thotë:

A nuk të ka mbërri lajmi i atyre që refuzuan besimin më parë?\* Ata e shijuan rezultatin e veprave të tyre, dhe për ta është dënimi i madh\* Kjo ishte për shkak se të Dërguarit u vinin atyre me shenja të qarta, por ata thanë: "A do të na udhëzojë neve një qenie njerëzore e thjeshtë?" Ashtu që

ata e refuzuan besimin dhe u kthyen prapa. Dhe Allahu nuk ka nevojë për ndonjë gjë. Allahu është i lirë nga të gjitha nevojat, i denjë për tërë lavdërimin\*. Jobesimtarët imagjinojnë se ata s'do të ngrihen (për gjykim) Thuaj: Po, pasha Zotin tim, ju do të ngriheni, pastaj do të informoheni për tërë atë që keni bërë, dhe kjo është shumë lehtë për Allahun. (Kur'an 64:5-7)

Allahu ka përmendur gjendjen e atyre të cilët kundërshtojnë dhe nuk u binden Pejgamberëve, si dhe dënimin e kërcënuar i cili i pret ata në Jetën e Përtejme në shumë kaptina të Kur'anit. Në mesin e tyre: Kaf, el-Kamer, el-Mu'min, es-Sexhde, ez-Zuhruf, ed-Dukhan, dhe shumë të tjera.

## **PREMTIMET DHE KËRCËNIMET ME DËNIM QENË PJESA E PARË E SHPALLJES**

Teuhidi, premtimet për shpërblime, dhe kërcënimet e dënimit qenë gjërat e para të shpallura të Kur'anit. Në sahi Buhari, Jusuf ibn Mahek rrëfen:

“Unë isha te A'isha, Nëna e besimtarëve, Allahu qoftë i kënaqur me të, kur një Irakian erdhi te ajo dhe tha: “Cili qefin është më i miri?” A'isha tha: “Mjer ti, çfarë të ka ndodhur?” Ai tha: “O nënë e besimtarëve, ma trego mus-hafin tënd” A'isha tha: “Pse?”

Ai tha: “Me qëllim që ta rregulloj Kur'anin sipas tij, sepse ai është duke u lexuar pa ndonjë rend të caktuar.”

A'isha tha: "Çfarë ka të keqe në atë se cila pjesë lexohet së pari? Vërtet, e para prej tyre që është zbritur ka qenë një sure nga mesi i sureve të shkurta në të cilën përmenden Parajsa dhe Zjarri. Pasi që njerëzit u nënshtruan (hynë në Islam), qenë shpallur harami dhe hallali. Sikur gjëja e parë që do të shpallej të ishte "Mos konsumoni alkool" ata do të thonin: "Ne kurrë s'do ta lëmë alkoolin." Dhe sikur gjëja e parë që do të shpallej të ishte "Mos bëni kurvëri dhe tradhti bashkëshortore.", ata do të thoshin: "Ne kurrë s'do ta lëmë kurvërinë." Vërtet, ajeti vijues i qe shpallur Muhamedit në Meke derisa unë isha vajzë e re lozonjare: **Jo, çasti i gjykimit është më i rëndë dhe më i hidhur** (d.m.th. më shumë se çdo vështirësi që Muslimani mund të hasë në rrugën e Allahut në këtë jetë), dhe kapitujt e el-Bekares dhe en-Nisa (të cilat përmbajnë vendime gjithëpërfshirëse mbi hallallin dhe haramin) qenë shpallur vetëm derisa unë isha me të (salallahu alejhi ue selam) si bashkëshorte e tij." Pastaj, A'isha mori mus-hafin e tij dhe i diktoi atij ajetet e kaptinës."



## DALLIMET NË LIDHJE ME URDHËRIMIN DHE NDALIMIN JANË SHKAK PËR NDARJE

Kufri, çoroditja, dhe mosbindja janë shkak i së keqes dhe konfliktit. Personi apo grupi mund të bie në mëkat dhe mosbindje. Pastaj një grup tjetër hesht, dhe nuk e përmbush detyrën e tyre të urdhërimit për të mirën dhe ndalimit prej të keqes, dhe kjo bëhet mëkat i tyre. Dhe një grup tjetër urdhëron dhe ndalon, por në mënyrë të cilën e ka ndaluar Allahu, dhe kjo bëhet mëkat i tyre. Rezultati përfundimtar është përçarja, dallimi, konflikti, dhe e keqja. Kjo është një prej burimeve më të mëdha të së keqes dhe kaosit në të gjitha kohërat, të kaluarat dhe të tanishmet. Kjo sepse njeriu nga natyra është dhalum (përherë i dhënë pas kriminalitetit), dhe xhahul (përherë i dhënë pas injorancës dhe marrëzisë). Shiko Kur'anin 72:33. Ky kriminalitet apo shtypje, dhe kjo marrëzi janë të llojeve të ndryshme. Shtypja dhe marrëzia e personit apo grupit të parë (atij që bën mosbindje zanafillore) është e një lloji, derisa shtypja dhe marrëzia e grupit të dytë dhe të tretë (ata që e dinin dhe heshtën, dhe ata që urdhëruan dhe ndaluan në mënyrën e cila s'është e lejuar me Islam) është e llojeve të tjera.

Çdonjëri që soditë mbi konfliktin dhe kaosin i cili i ka kapluar Muslimanët, do të shohë se kjo vërtet është shkak i tyre. I tërë konfuzioni i cili ndodh në mes të sunduesve të Umetit, dhe dijetarëve të tij, dhe atyre që i pasojnë ata nga mesi i njerëzve të rëndomtë e ka këtë si

shkak rrënjësor të vetin. Po ashtu në këtë kategori janë arsyet e ndryshme të shmangies: epshi në çështjet fetare dhe të kësaj bote, risitë në fe (bid'a), dhe shthurja në këtë jetë. Këto gjëra janë të përgjithshme, dhe ndikojnë në tërë racën njerëzore për shkak të elementit në to të kriminalitetit dhe marrëzisë. Kështu, disa nga njerëzit mëkatojnë duke e shtypur veten (d.m.th. me çfarëdo mosbindje ndaj Allahut) apo të tjerët duke bërë kurvëri, apo homoseksualizëm, apo duke konsumuar alkool, apo krimet ekonomike siç është tradhtia e besimit, vjedhja, uzurpimi i pronës së njerëzve duke frikësuar, dhe krime tjera të ngjashme.

## MËKATET JANË TË DËSHIRUARA PËR NATYRËN NJERËZORE

Është e njohur se këto mëkate dhe akte të mosbindjes, ndonëse kuptohet se janë të urryera dhe të dënueshme nga mendimi intelektual dhe nga kriteri Islam, janë të dëshiruara nga natyra njerëzore. Është një gjendje normale e unit njerëzor që ai nuk dëshiron që të tjerët të kanë atë që ai nuk e ka, apo të kenë diçka më shumë se ajo. Më saktë, ai dëshiron që e mira që u ka ardhur të tjerëve të vijë tek ai. Kjo është e njohur në Arabisht si Ghabta, e cila është më e vogël nga dy format e inatit. Kështu, uni njerëzor dëshiron që të jetë superior apo mbi të tjerët, dhe të jetë i preferuar tek ata, apo ka inat ndaj tyre, dhe dëshiron shkatërrimin e gjërave të mira që u kanë ardhur të tjerëve, edhe nëse vetë nuk do ta merr atë (kjo është forma ekstreme e inatit). Pra, uni njerëzor përmban këto elemente të të dëshiruarit e superioritetit, çoroditjes, mburrjes, dhe inatit i cili e bën atë që t'i posedojë dëshirat e tija mbi të tjerët. Si do të ndihej uni kur i sheh të tjerët se posedojnë atë që ai e dëshiron derisa ai nuk e ka marrë atë? Dëshirat më të arsyeshme të tyre janë që të gjithë t'i kenë dëshirat e tyre në baza të barabarta, dhe s'mund të tolerojnë që disa të kenë më shumë se ata. Ndërsa sa u përket të tjerëve (d.m.th. ata cilët dëshirojnë shkatërrimin e gjërave të mira të poseduara nga të tjerët për shkak se ata s'kanë pasur mundësi që ta marrin atë), ata janë tiranë ziliqarë.

Këto dy lloje të inatit ndodhin në lidhje me gjërat të cilat Allahu i ka lejuar, si dhe në lidhje me gjërat të cilat janë ndaluar me te drejtat e Allahut mbi robërit e Tij. Për sa i përket asaj që është e llojit të parë siç është ushqimi dhe pijet, fatit bashkëshortor, veshjes, ngasjes së shtazëve, pasurisë, posedimi ekskluziv i këtyre gjërave nga disa dhe jo nga të tjerët mund të jetë shkak i shtypjes, koprracisë, dhe inatit.

## LAKMIA ËSHTË SHKAK I SHMANGIES

Origjina e të gjitha këtyre problemeve është dëshira lakmitare (shuhh). Pejgamberi e shpjegon këtë në hadithin sahi vijues:

“Ruajuni nga shuhh (dëshira lakmitare), se vërtet ajo i ka shkatërruar ata që erdhën para jush. Ajo i urdhëroi ata që të jenë koprracë dhe ata qenë koprracë, ajo i urdhëroi që të shtypin (bëjnë padrejtësi) dhe ata shtypën, dhe ajo i urdhëroi që t’i shkëputin lidhjet familjare dhe ata i shkëputën lidhjet familjare.”

Për këtë arsye, Allahu i ka lavdëruar Ensarët (Muslimanët e Medines të cilët i pranuan ata që migruan prej Mekes, dhe i ndihmuan ata) për atë se ata kishin cilësi të kundërta, duke thënë:

Dhe ata të cilët kishin përgatitur vendbanimin dhe (pranuan) besimin para tyre (d.m.th. para atyre të cilët migruan prej Mekes) i duan ata që migruan tek ta, dhe nuk gjejnë në zemrat e tyre ndonjë nevojë për gjërat e mira që u janë dhënë atyre. (d.m.th. ata nuk kanë inat për atë që u është dhënë vëllezërve të tyre – Migruesve). Dhe ata i preferojnë të tjerët madje edhe para vetes së tyre, edhe pse ata janë nevojtarë. Dhe kushdo që është i mbrojtur nga lakmia e vetvetes, ata janë të suksesshmit. (Kur’an 59:9)

Abdur-Rahman ibn Auf – një shoqërues i Pejgamberit – qe dëgjuar duke thënë pasi që bëri Tavafin e tij rreth Kabes:

“O Zot, më mbroj nga lakmia e vetes sime. O Zot, më mbroj nga lakmia e vetes sime.” Kur ai u pyet për këtë lutje të tij, ai tha:

“Nëse unë jam i mbrojtur nga lakmia e vetes sime, Unë do të jem i mbrojtur nga koprracia, shtypja, dhe shkëputja e lidhjeve familjare.”

Shuhh, e cila është dëshira lakmitare e unit, shkakton koprracinë duke mbajtur objektet e dëshirës të cilat janë kërkuar, dhe shkakton shtypjen me marrjen e pronës së të tjerëve, dhe shkakton shkëputjen e lidhjeve familjare, dhe shkakton inat – e cila është urrejtja e të tjerëve për atë se posedojnë atë që ai nuk e ka, dhe ka dëshirë për shkatërrimin e asaj.

Çdo inat sjellë koprraci dhe shtypje, meqë inati është koprraci me atë që i është dhënë personit, ndërsa shtypja/padrejtësia është dëshira që të tjerët ta humbin të mirën të cilën e kanë fituar.

Meqë ky është rasti i atyre gjërave të dëshiruara të cilat janë hallall, çfarë është rasti në lidhje me gjërat e lejuara të cilat janë haram, siç është kurvëria, pirja e alkoolit, etj? Kur disa njerëz i marrin apo i praktikojnë gjërat e këtilla, do të shfaqen dy lloje të urrejtjes: 1) Që të urrehet ajo për shkak se të tjerët e kanë atë që ai se ka dhe 2) Të urrehet ajo për hir të Allahut, dhe për shkak se ajo sjell dhunimin e të drejtave të Allahut ndaj robërve të Tij.

## LLOJET E MËKATEVE

Për këtë arsye, mëkatet ndahen në tri lloje:

Mëkatet të cilat u sjellin shtypje të tjerëve, siç është marrja e pronës së njerëzve, mohimi i drejtave të tyre, inati apo të tjera (të llojit më të madh), etj.

Mëkatet të cilat sjellin vetëm shtypje të vetvetes, siç është pirja e alkoolit, dhe kurvëria kur dëmet e saja nuk ndikojnë tek të tjerët.

Mëkatet të cilat sjellin të dyja këto që i përmendëm më lart, siç është Emiri apo sunduesi i cili merr pronën e njerëzve për ta shfrytëzuar atë për kurvëri apo pije dehëse, apo krime të tjera. Një shembull tjetër është ai i cili bën akte seksuale të paligjshme me dikë, dhe pastaj e shpalos këtë para njerëzve me qëllim që ta dëmtojë personin e përfshirë, siç është parë shpesh nga ata që janë të obsesionuar me femra dhe djelmosha të rinj. Allahu thotë:

Thuaj, e tërë ajo që Zoti im ka ndaluar janë aktet e neveritura, ato që janë të dukshme dhe ato që janë të fshehta, dhe mëkatet, dhe shtypja/tirania pa ndonjë arsyetim, dhe që ju të shoqëroni me Allahun atë për të cilën nuk është dërguar kurrfarë autoriteti, dhe që ju të thoni për Allahun atë që nuk e dini. (Kur'an 7:33)

## SUKSESI NË ÇËSHTJET E KËSAJ BOTE ARRIHET ME DREJTËSI

Çështjet e kësaj bote do të shkojnë më mirë me praninë e drejtësisë e cila mund të përzihet me ndonjë prej llojeve të mëkatit, se që do të shkojnë mirë me praninë e shtypjes dhe padrejtësisë në të drejtat e njerëzve, edhe nëse ajo s'është e përzier me mëkate tjera. Kështu, është thënë: "Allahu e vendos shtetin e drejtë edhe nëse është jobesimtar, dhe nuk e vendos shtetin shtypës edhe nëse është Musliman."

Është thënë: "Çështjet e kësaj bote zgjasin me drejtësi dhe kufër (mosbesim), por ato nuk zgjasin me shtypje/padrejtësi dhe Islam."

Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) ka thënë:

"Të këqijat që dënohen më së shpejti janë padrejtësia dhe shpërblimet e lidhjeve familjare." (Ibn Maxhe)

Kështu, shkelësi i padrejtë është i dërrmuar në këtë jetë, edhe pse ai përfundimisht mund të falet në Jetën e Përtejme.

Kjo sepse drejtësia është sistemi i çdo gjëje. Pra, kur çështjet e kësaj bote të jenë të vendosura me drejtësi, ato zgjasin dhe janë të qëndrueshme, ndonëse autori i saj mund të mos ketë pjesë në shpërblimet e Jetës së Përtejme, dhe kur ato s'janë të vendosura me drejtësi, ato nuk zgjasin, edhe pse autori i saj mund të ketë atë besim për të cilin ai mund të shpërblehet në Jetën e Përtejme.



## NATYRA NJERËZORE: TIRANI, INAT DHE SHTYPJE

Përbrenda unit njerëzor është një shtytje për t'i shtypur të tjerët duke i tiranizuar ata, duke ua pasur zili atyre, dhe duke i cenuar të drejtat e tyre. Përbrenda tij, po ashtu, janë shtytjet për ta shtypur veten duke u shfrenuar në akte të neveritura, siç është kurvëria dhe konsumimi i gjërave të papastra. Kështu, personi mund t'i shtyp të tjerët pa qenë i shtypur ai vetë, dhe mund të jepet pas këtyre kënaqësive, ndonëse askush përreth tij s'i bën ato. Sidoqoftë, kur ai sheh shokët e tij duke shtypur, apo duke u shfrenuar në këto kënaqësi, në të paraqitet një shtytje që t'i bëjë këto gjëra e cila është shumë më e fortë se ajo e mëparshme.

Kjo po ashtu mund të shkaktojë në personin urrejtje ndaj atyre të cilët e kanë objektin e dëshirave të tij të ulëta, inatin e tij ndaj tyre, dhe dëshirën e tij për dënimin e tyre dhe largimin e atij sendi të cilin ata e kanë i cili përndryshe s'ishte aty. Ai ka një arsyetim të mjaftueshëm për këtë nga drejtimi i mendimit intelektual, dhe nga parimet Islame për shkak të faktit se ata të cilët ai i kundërshton janë duke e shtypur veten dhe Muslimanët si tërësi, dhe urdhërimi i tij për të mirën dhe ndalimi prej të keqes dhe xhihadi luftues në kërkim të asaj na paraqitet të jetë nga Islami.

## KATEGORITË E NJERËZVE NË KËTË ÇËSHTJE

Njerëzit, në lidhje me këtë çështje, mund të ndahen në tri kategori:

Një grup nuk zgjohet, përveç me epshin e vetes së tyre. Ata s'janë të kënaqur, përveç me ato gjëra të cilat u janë dhënë atyre, dhe nuk hidhërohen, përveç për shkak të diçkaje e cila u është mohuar atyre. Nëse personit të tillë i jepet çdo gjë që dëshiron prej hallallit dhe haramit, hidhërimi i tij zhduket dhe ai është i kënaqur. Kur atij i përmbushen dëshirat e tija, ato gjëra të cilat ai i ka quajtur të këqija, nga të cilat ai aktivisht i ndalonte të tjerët dhe i dënonte ata për shkak të shfrenimit në to, hidhërohej me to, dhe haptazi i kritikonte ato, kur ai i merr këto gjëra, ai përnjëherë bëhet një i shfrenuar në to, dhe ortak e ndihmës i shfrytëzuesve të tyre, dhe një armik i patundur i atyre që i urdhërojnë njerëzit të rrinë larg këtyre gjërave, dhe ua përmend atyre të këqijat e tyre. Kjo është shumë e përhapur në mesin e bijve të Ademit. Ne të gjithë i shohim dhe dëgjojmë shembujt e kësaj, numri i të cilave është i panjohur përveç për Allahun. Shkaku i kësaj është ajo se njeriu është, siç ka thënë Allahu, përherë i dhënë pas kriminalitetit (dhalum), dhe përherë i dhënë pas injorancës dhe marrëzisë (xhahul). Dhe kështu, shumë prej tyre kurrë nuk e praktikojnë drejtësinë; më saktë, ata mund të jenë shtypës në të dy gjendjet. Për shembull, mund të jetë një grup njerëzish të cilët kritikojnë shtypjen e sunduesit dhe shkeljen e tij të drejtave të qytetarëve, dhe sunduesi i qetëson ata me ndonjë pozitë apo para.

Përnjëherë, ata bëhen ndihmësit dhe përkrahësit më të mëdhenj të sunduesit apo qeverisë së padrejtë. Do të ishte më mirë për ta sikur vetëm të kishin mbetur të heshtur dhe të përmbajtur nga urdhërimi për të mirën dhe ndalimit prej të keqes në rend të parë.

Në mënyrë të njëjtë, ju mund t'i shihni këta njerëz duke u sjellur shumë ashpër me ata që marrin pije dehëse, kurvërojnë dhe dëgjojnë muzikë derisa ata të arrijnë që ta përfshijnë atë në mëkatet e tyre, apo ta paqësojnë atë me diçka prej kënaqësive të tyre në të cilat ata shfrenohen. Në atë kohë, ju do t'i shihni ata duke u bërë ndihmësit më të mëdhenj të atyre akteve të cilat ata i kundërshtonin aq ashpër më parë. Njerëzit e këtillë, kur ndër marrin urdhërimin për të mirën dhe ndalimin prej të keqes mund të vijnë në një gjendje edhe më të keqe se gjendja e tyre para se ata të fillonin, apo ndoshta jo edhe aq e keqe, apo të barabartë me të.

Të tjerët, e kanë marrë qëndrimin korrekt të fetarisë dhe devotshmërisë. Ata janë të sinqertë ndaj Allahut në atë, dhe në veprat e tyre reformues dhe prurës të së mirës. Në këtë atyre u është dhënë sukses i atillë sa që ata janë në gjendje të jenë durimtarë dhe i vetëpërmbajtur përballë persekutimit. Këta janë **“ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira”**, dhe ata janë “populli më i mirë i ngritur për njerëzimin: ata urdhërojnë në atë që është e mirë dhe e ndalojnë atë që është e keqe, dhe ata besojnë në Allahun.

Grupi i tretë është kombinim i karakteristikave të grupit të parë dhe atyre të dytit, dhe këta janë shumica e besimtarëve. Kushdo që kombinon devotshmërinë, epshin,

dhe dëshirat, ka në zemrën e tij vullnet që të jetë i dëgjueshëm ndaj Allahut, dhe vullnet që ta kundërshtojë Allahun në dëgjueshmëri ndaj dëshirave të tija. Nganjëherë mbizotëron e para, dhe nganjëherë mbizotëron e dyta.

Ndarja trepjesësh është e ngjashme me ndarjen e shpirtave të njerëzve në tri lloje, siç aludohet në Kur'an: Ammaare (ai i cili gjithmonë urdhëron, d.m.th. e keqja), Leuame (ai i cili gjithmonë kritikon dhe merr në llogari, d.m.th. shpirtat të cilët i binden Allahut pa ndonjë kundërshtim të brendshëm). Kështu, grupi i parë më lart janë poseduesit e shpirtit i cili është Ammare, d.m.th. gjithmonë i urdhëron ata që të bëjnë keq, dhe grupi i dytë lart janë poseduesit e shpirtit i cili është Mut'me'ineh, të cilëve Allahu do t'u thotë në ditën e Kijametit:

O ju shpirta të qetë: Kthehuni te Zoti juaj, të kënaqur dhe të pranuar, dhe hyni në mesin e robërve të Mi, dhe hyni në Parajsën Time. (Kur'an 89:27-30)

Grupi i tretë dhe më i madhi janë poseduesit e shpirtit i cili është Leuaameh, i cili bën mëkate dhe pastaj e fajëson veten për to. Ai i ndërron ngjyrat, nganjëherë kështu dhe nganjëherë ashtu. Ai "e përziën punën e mirë me një tjetër e cila është e mirë".

Shpresohet se Allahu do t'i falë këta njerëz me kusht që ata t'i pranojnë mëkatet e tyre dhe të pendohen, siç ka thënë Allahu:

Dhe të tjerët i kanë pranuar mëkatet e tyre. Ata e përziptën punën e mirë me një tjetër e cila ishte e keqe.

Ndoshta Allahu do t'i falë ata, vërtet Allahu fal shumë, është më i Mëshirshmi. (Kur'an 9:102)

Është për këtë arsye që gjatë Hilafetit të Ebu Bekrit dhe Umerit – dhe ata janë të dytë me të cilët Muslimanët janë urdhëruar të maten, siç ka thënë Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam):

“Pasoni shembullin e dyve që vijnë pas meje: Ebu Bekr dhe Umer.” (et-Tirmidhi, Ibn Maxhe, dhe Ahmed)

Meqë Muslimanët ende ishin afër epokës së shpalljes, dhe me të fortë në fe dhe devotshmëri, dhe udhëheqësit e tyre ishin më të ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrave të tyre, dhe më të rehatshëm dhe të lirë nga kundërshtimet e brendshme – kaosi, gjakderdhja dhe konflikti i cili pasoi, mungonte gjatë dy Hilafeteve të tyre. Kjo sepse ata ishin sikur njerëzit e kategorisë së dytë: ata, vetat e të cilëve janë të rehatshme dhe të lira nga kundërshtimet e brendshme në lidhje me Islamin.

Pastaj, në fund të Hilafetit të Uthmanit, dhe gjatë Hilafetit të Aliut (Allahu qoftë i kënaqur me të dytë), ata të kategorisë së tretë u bënë më të shumtë. Kështu, në Muslimanët u shfaqën dëshirat dhe epshet së bashku me praninë e besimit dhe praktikimit Islam. Kjo u bë edhe më e rëndë, dhe fitneja (konflikti) ngjau, shkak i së cilës është ashtu siç shpjegoam më herët. Të dy anët dështuan që të analizojnë si duhet diktatet e devotshmërisë dhe bindjes ndaj Allahut. Të dy anët e përzien të kuptuarit e tyre të devotshmërisë dhe bindjes me disa elemente të epshit dhe mosbindjes. Secila anë, në interpretimin e vet, duke besuar

se janë duke urdhëruar për të mirën dhe duke ndaluar prej të keqes, dhe atë se ata janë në anën e së vërtetës dhe drejtësisë. Ky interpretim, sidoqoftë, përmban një element të epshit dhe një element të dyshimit, dhe pasimin e dëshirave të unit, ndonëse njëra prej dy palëve që më afër të vërtetës se tjetra.

Për këtë arsye, besimtarit i takon që vazhdimisht t'i lutet Allahut që ta ndihmojë atë, dhe të mbështetet plotësisht në Allahun që ta mbushë zemrën e tij me besim dhe devotshmëri, dhe të mos e lë atë të kontaminohet, dhe ta vendosë atë fort në udhëzim, dhe ta mbrojë atë nga pasimi i epshit të tij, siç thotë Allahu:

Dhe për këtë shkak, lutu dhe qëndro i palëkundur ashtu siç je urdhëruar të bësh, dhe mos paso epshet e tyre. Dhe thuaj: Unë kam besuar në librin të cilin Allahu e ka zbritur, dhe jam urdhëruar që ta vejë drejtësinë mes jush. Allahu është Zoti jonë dhe Zoti juaj. (Kur'an 42:15)

## **E MIRA DUHET TA MBËSHTESË TË MIRËN, ASHTU SIÇ E KEQJA E MBËSHTET TË KEQEN**

Kjo po ashtu është kusht i Umetit në ato çështje për të cilat ai është përcarë dhe ndarë në mendime mbi thëniet dhe aktet e adhurimit. Këto çështje janë në mesin e gjërave të cilat u shkaktojnë sprova të mëdha besimtarëve. Ata kanë nevojë të madhe për dy gjëra: Nevojën për ta zmbursur të keqen me të cilën janë dëmtuar shokët e tyre, s'i në çështjet fetare ashtu edhe në ato të kësaj bote, larg prej tyre, përkundër shtytjes përbrenda tyre që i thërret ata në të njëjtat gjëra. Ata, po ashtu, kanë ego dhe shejtana (që i thërrasin ata në të keqen), mu ashtu siç ata të cilët tashmë kanë rënë në të keqen. Kështu, kur e keqja shihet në shokët e tyre, tendencat djallëzore përbrenda vetes së tyre rriten. Pra, edhe pas eliminimit të së keqes përreth tyre, besimtarët do të mbeten me shtytjet djallëzore përbrenda tyre dhe me pëshpëritjet e shejtanit. Motivuesit drejt së mirës janë saktësisht në një situatë të ngjashme: Besimtarët kanë nevojë që ta zbatojnë bamirësinë në të tjerët si një motivim drejt së mirës, si dhe pasimin e tendencave të brendshme të tyre drejt së mirës.

Për këtë arsye ka aq shumë njerëz të cilët kurrë nuk aspirojnë që të bëjnë mirë derisa të shohin dikë tjetër – posaçërisht në mesin e atyre të cilët i konsiderojnë si “shokë” – duke e bërë ndonjë vepër të caktuar. Në atë pikë, ata do të bëhen të interesuar dhe do ta ndërmarrin atë veprim, po ashtu. Njerëzit janë sikurse puplat e hutit,

ata instinktivisht anojnë nga konformizmi dhe imitimi i njëri-tjetrit.

Për këtë arsye, shpërblimi dhe përgjegjësia e atij i cili vendos një vepër të re për herë të parë, është e njëjta sikur e atyre të cilët e pasojnë atë në këtë. Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) ka thënë:

“Kushdo që e vendos një traditë të mirë, do të shpërblehet për të së bashku me shpërblimet e të gjithë atyre të cilët e pasojnë atë deri në ditën e Kijametit, pa i zvogëluar kjo aspak shpërblimet e tyre. Dhe kushdo që e vendos një traditë të keqe, do t’i ngarkohet tërë përgjegjësia e saj së bashku me përgjegjësitë e të gjithë atyre të cilët e pasojnë atë deri në ditën e kijametit, pa e zvogëluar përgjegjësinë e tyre aspak. (Muslim)

Kjo sepse realiteti i tyre është një, dhe statusi i diçkaje është statusi i të barabartës me të, dhe ajo e cila është e ngjashme me diçka është vazhdim i saj.

Tash, meqë këta dy motivues janë të fortë (d.m.th. shtytja e brendshme drejt të mirës dhe drejt të keqes, dhe motivimi i shtuar që rezulton nga të parët e të tjerëve duke bërë mirë apo duke bërë keq), imagjinojeni situatën kur dy motivues shtesë t’u jenë shtuar atyre:

Kjo është situata ku shumë njerëz të këqij e duan ndonjë i cili pajtohet me ta dhe programin e tyre, dhe ata i urrejnë ata të cilët s’pajtohen me ta. Kjo është shumë e qartë në mesin e feve të ndryshme të rrejshme: secili grup është tej mase besnik dhe i përkushtuar ndaj (dhe vetëm ndaj) atyre të cilët pajtohen me ta, dhe është tej mase armiqësorë ndaj



atyre të cilët s'pajtohen me programet apo besimet e tyre. Ky vazhdimisht është rasti në çështjet e kësaj bote po ashtu. Ata të cilët shfrenohen në ndonjë formë të caktuar të kënaqësisë, vazhdimisht i zgjedhin dhe i preferojnë për shokë dhe shoqërues ata të cilët e ndajnë kënaqësinë e caktuar të tyre. Kjo mund të jetë me qëllim që të ndihmojnë njëri-tjetrin në kërkim të kënaqësisë së tyre, s'i në rastin e atyre të cilët komplotojnë së bashku që ta marrin pushtetin dhe ta tiranizojnë një vend, apo të formojnë banda dhe të plaçkitin njerëzit dhe të ngjashme me këto. Apo, kjo mund të jetë thjesht për ëmbëlsinë e shoqërimit dhe pajtimit, s'i në rastin e atyre të cilët bëhen bashkë që të konsumojnë pije alkoolike. Ata dëshirojnë që secili që është i pranishëm të merr pjesë në ahengun e tyre, dhe s'mund të tolerojnë praninë e atij që nuk pi. Ndoshta kjo është për shkak të urrejtjes së tyre për atë se ai është më i mirë se ata, duke qëndruar larg nga mëkatet e tyre, apo nga inati ndaj mundësisë së tij që t'i rezistojë sprovës, apo që ai mos të paraqitet superior ndaj tyre dhe të jetë i lavdëruar nga njerëzit për abstenimin e tij përkundër shfrenimit të tyre, apo me qëllim që ai të mos ketë ndonjë argument apo dëshmi kundër tyre, apo nga frika se ai do t'i shantazhojë ata me atë, dhe t'i poshtërojë ata, apo arsye tjera të këtilla. Allahu ka thënë:

Shumë nga njerëzit e librit dëshirojnë që t'ju kthejnë prapa pas besimit tuaj, që të bëheni jobesimtarë, nga inati që kanë përbrenda vetes së tyre, edhe pasi që e vërteta u është bërë e qartë atyre. (Kur'an 2:109)

Dhe Ai tha në lidhje me hipokritët:

Ata dëshirojnë që ti të mohosh ashtu siç kanë mohuar ata, dhe të gjithë të jeni të njëjtë. (Kur'an 4:89)

Halifeja Uthman ibn Affan ka thënë njëherë e një kohë:

“Kurorëshkelësja (zinaqarja) dëshiron që të gjitha gratë të bëjnë tradhti bashkëshortore.”

Bashkimi i tyre në kënaqësi mund të jetë shpërndarje e mëkatit të njëjtë, siç është konsumimi i pijeve dehëse së bashku, tregimi i gënjeshtreve dhe përhapja e falsifikimeve, dhe mbajtja e besimeve të çoroditura. Apo, ata mund të zgjedhin që të shpërndajnë mëkatin në kuptimin abstrakt, si në rastin e kurorëshkelësit i cili dëshiron që edhe të tjerët po ashtu të bëjnë tradhti bashkëshortore, apo vjedhësi i cili dëshiron që edhe të tjerët të vjedhin – ata dëshirojnë që edhe të tjerët të marrin pjesë në llojin e mëkatit të tyre, por jo edhe mu objektin e njëjtë të cilin dëshirojnë ta vjedhin, apo të kenë marrëdhënie seksuale të paligjshme.

Motivi i dytë shtesë është siç vijon: Ata mund të urdhërojnë një individ që të merr pjesë me ta në veprimin e tyre të paligjshëm; nëse ai pajtohet që të merr pjesë, ai lihet vetëm, por nëse ai reziston, ata bëhen armiq aktivë të tij, duke e persekutuar atë në një mënyrë e cila madje mund të bëhet shtrëngim.

Pastaj, këta njerëz të njëjtë të cilët e dëshirojnë pjesëmarrjen e të tjerëve në veprimet e tyre të neveritura, apo në të vërtetë i urdhërojnë ata që të veprojnë kësisoj,

dhe kërkojnë ndihmën e të tjerëve me qëllim që ta sjellin atë në rrugën e tyre, deri në pikën kur ai pajtohet të merr pjesë në veprimet e tyre, dhe t'i ndihmojë ata, dhe t'i dëgjojë ata, ata në atë pikë do ta respektojnë atë shumë pak, dhe do ta nënçmojnë dhe shikojnë me përçmim. Kjo, atëherë, do të behet argumenti dhe dëshmia e tyre kundër tij dhe kundër dëgjimit të çfarëdo qoftë që ai thotë edhe në fushat tjera po ashtu. (Ata e thërrasin dhe e nxisin atë në ndonjë akt të caktuar që ta turpërojnë atë në sytë e njerëzve!!!) Kjo është gjendja e shumicës së shtypësve, të cilëve u është dhënë pak autoritet në vend.

Këta motivues të njëjtë, të cilët janë të pranishëm në bërjen e së keqes, po ashtu janë të pranishëm në lidhje me bërjen e së mirës dhe kryesve të saj, dhe madje është edhe më e fortë. Siç ka thënë Allahu:

Dhe ata që besojnë janë më të fortë në dashuri për Allahun. (Kur'an 2:166)

Vërtet, çdo person po ashtu ka një shtytje të brendshme që e thërret atë në besim dhe dituri, sinqeritet dhe drejtësi, dhe përmbushjen e detyrave. Kështu, nëse ai gjen të tjerë të cilët i bëjnë këto gjëra siç ai bën, atëherë ngrihet një motivues shtesë, posaçërisht nëse ata janë çka ai i konsideron si "shokë", dhe posaçërisht nëse ka ndonjë atmosferë të "garimit" në bamirësi. Ky është lloji i lavdërueshëm i garimit.

Pastaj, nëse ai gjen të tjerë të cilët e duan pajtimin e tij me ta në atë që është e mirë, dhe pjesëmarrjen në të nga mesi i besimtarëve të drejtë, të cilët po ashtu e urrejnë atë

kur ai shmanget apo nuk e bën atë që është e mirë, atëherë ngrihet motivuesi i tretë.

Pastaj, nëse ata e urdhërojnë atë që të bëjë mirë, dhe janë besnikë dhe të përkushtuar ndaj tij kur ai vepron mirë, dhe e kundërshtojnë atë dhe e dënojnë atë kur ai e neglizhon atë, atëherë ngrihet motivuesi i katërt.

## **E KEQJA DUHET TË PËRBALLET ME TË MIRËN**

Për këtë arsye, besimtarët janë urdhëruar që veprat e këqija t'i përballin me të kundërtën e tyre, mu ashtu siç mjeku i kundërvihet sëmundjes me të kundërtën e saj. Pra, besimtari është i urdhëruar që ta reformojë veten, dhe kjo bëhet me anë të dy gjërave: bërjes së veprave të mira, dhe shmangien nga veprat e këqija. Dhe kjo përkundër forcave dhe motivuesve të cilat e kundërshtojnë bërjen e së mirës dhe e inkurajojnë bërjen e së keqes, dhe të dyja këto janë katër llojesh, siç kemi thënë.

Besimtari po ashtu është i urdhëruar që t'i reformojë të tjerët me të gjithë këta katër motivues sipas mundësive të tija të fuqisë dhe aftësisë. Allahu thotë:

Pasha kalimin e kohës\* Vërtet, njeriu është në një humbje të mjerë\* Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira\* Dhe e përkujtojnë njëri-tjetrin për të vërtetën, dhe e këshillojnë njëri-tjetrin që të kenë durim. (Kur'an 103)

Është transmetuar se Imam Shafi'i ka thënë:

“Sikur të gjithë njerëzit të mendonin për Suren el-Asr, kjo do t’u mjaftonte atyre.”

Është ashtu siç ka thënë ai. Allahu na ka informuar në këtë sure se të gjithë njerëzit janë në një humbje të mjerë, përveç atyre të cilët në veten e tyre janë besimtarë të drejtë, dhe me të tjerët përkujtues i së vërtetës, dhe këshillues në durim.

## ASHPËRSIA E SPROVËS SHKAKTON NGRITJEN E POZITËS

Kur sprova bëhet e ashpër, kjo për besimtarin e drejtë bëhet shkak për ngritjen e gradave të tija dhe madhështinë e shpërblimit të tij, siç mund të shihet në hadithin vijues:

“Pejgamberi qe pyetur: ‘Cilët njerëz i kanë sprovat më të ashpra?’ Ai tha: ‘Pejgamberët, pastaj të drejtët, pastaj të tjerët në renditje zbritëse të drejtësisë së tyre. Secili sprovohet në pajtim me besimin e tij: nëse gjendet vendosmëria aty, sprovat e tija shtohen; nëse, në anën tjetër, ai është i dobët dhe i lëkundur në besim, sprovat e tija lehtësohen. Besimtari do t’ju nënshtrohet sprovave derisa të ecë në sipërfaqen e tokës pa asnjë mëkat të vetëm në të.”

Kështu, ai ka nevojë për durim më shumë se të tjerët, dhe kjo është arsyeja për udhëheqësi (Imamat) në besim, siç ka thënë Allahu:

Dhe Ne i bëmë ata udhëheqës (Imamë) të cilët i udhëzojnë (njerëzit) me urdhrin Tonë përderisa ata të jenë durimtarë, dhe t’i besojnë bindshëm shenjat tona. (Kur’an 32:24)

## **DURIMI ËSHTË I DOMOSDOSHËM NË TË BËRIT MIRË**

Muslimani duhet të ketë durim në të bërit e asaj në çka është urdhëruar, dhe në shmangien prej asaj e cila i është ndaluar atij. Po ashtu në këtë përfshihet edhe durimi përballë persekutimeve, kur flitet keq për ne, dhe durim kur të ballafaqohemi me fatkeqësi të ndryshme. Po ashtu, durimi kërkohet në kohërat e rehatisë dhe bollëkut, ashtu që të mos krenohemi, mburremi, dhe të bëhemi arrogantë, dhe lloje tjera të durimit.

## **NEVOJA PËR SIGURINË E BESIMIT**

S'është e mundur për personin që të ketë durim nëse ai s'ka ndonjë gjë prej së cilës do ta nxirrte paqen e brendshme, diçka prej së cilës ai arrin gëzimin dhe e cila i jep atij mbështetje: bindje në besim. Pejgamberi ka thënë në hadith:

“Luteni Allahun për falje dhe shëndet të mirë se, vërtet, pas bindjes në besim, askujt nuk i është dhënë gjë më e mirë se shëndeti i mirë.”

Në mënyrë të njëjtë, kur ai urdhëron të tjerët që të bëjnë mirë, apo e do pajtimin e tyre me atë që është korrekte, apo ndalon të tjerët nga të bërit keq, ai duhet të jetë shumë i mirë ndaj të tjerëve me të cilët ai dëshiron të punojë në

këtë rrugë me mirësjellje e cila e sjellë suksesin e qëllimit të tij; largimin e asaj të cilën ai nuk e pëlqen, dhe arritjen e asaj të cilën ai e pëlqen. Shpirtat njerëzorë s'mund të tolerojnë diçka të hidhur, përveç nëse ajo është e përzier me diçka të ëmbël. Asgjë tjetër s'është e mundur. Për këtë arsye, Allahu paracaktoi institucionin e lidhjes së zemrave (te'lif ul-kulub), madje duke e caktuar atë për ata, zemrat e të cilëve duhet të tërhiqen në pjesën e Zekatit. Allahu i tha Pejgamberit të tij:

Zgjedhe vetëpërmbajtjen, urdhëro tërë atë që është e mirë, dhe largohu nga të marrët. (Kur'an 7:199)

Dhe, Allahu tha në një ajet tjetër:

Është e domosdoshme për urdhëruesin për të mirën që të jetë i durueshëm dhe të jetë i butë, dhe ky është guximi i vërtetë dhe bujaria e mirëfilltë.

Për këtë arsye, Allahu përmend shumë herë së bashku namazin dhe zekatin në Kur'an, dhe zekati është mirësjellje ndaj krijimit të Allahut. Ndërsa në një vend tjetër i përmend së bashku namazin dhe durimin. Që të tria janë të rëndësishme: namazi, zekati, dhe durimi. Çështjet e besimtarit nuk do të shkojnë mbarë, përveç me këto tria në lidhje me reformimin e vetvetes dhe në reformimin e të tjerëve, posaçërisht kur sprovat dhe konflikti të jenë jashtë kontrollit; atëherë nevoja për këto cilësi bëhet edhe më e madhe.

Nevoja për vetëpërmbajtje dhe durim është e rëndomtë për tërë racën njerëzore; çështjet e tyre kurrë s'do të mbarështohen, përveç me këto cilësi. Për këtë arsye, të



gjitha shoqëritë dhe kulturat e lavdërojnë guximin dhe bujarinë deri në atë të masë, saqë shumica e poemave që janë kompozuar për lavdërimin e dikujt ndalen në këto dy cilësi. Në mënyrë të njëjtë, të gjitha shoqëritë dhe kulturat i konsiderojnë si të dënueshme cilësitë e kundërta të koprracisë dhe frikës.

Çfarëdo çështje për të cilën pajtohen mendimtarët e tërë racës njerëzore, s'mund të jetë tjetër veçse e vërteta, siç është pajtimi i tyre në lavdërimin e sinqeritetit dhe drejtësisë, dhe dënimin e rrenës dhe shtypjes. Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) njëherë qe pyetur nga disa beduinë derisa ata e shtynë atë afër një lisi në të cilin u ngatërrua manteli i tij. Ai u kthye nga ata dhe tha:

“Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, sikur të posedoja deve aq sa numri i këtyre gjembave, unë do t'i kisha ndarë ato në mes jush, dhe ju nuk do të më gjenit koprrac, as frikacak, e as të rremë.”

Ky gjykim i vlerësuar, merr forma të ndryshme sipas rasteve dhe detajeve specifike dhe, vërtet, veprat gjykohen sipas qëllimeve, dhe çdonjërit i takon ajo të cilën e ka pasur qëllimin.

## KRITICIZMI I KOPRACISË DHE FRIKËS

Për këtë arsye, koprracia dhe frika shpesh kritikohen në Kur'an dhe Sunet, ndërsa guximi dhe vetëpërmbytja në rrugën e Allahut lavdërohen – në rrugën e Allahut specifikisht përderisa është kundërshtim me atë e cila s'është në rrugën e Allahut. Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) ka thënë:

“Gjërat më të këqija që mund të gjinden në personin janë dëshira lakmitare e cila ndikon në të gjitha veprat e tija, dhe frika e cila e bën atë të ikë.”

Dhe, ai tha:

“Kush është udhëheqësi juaj, O fëmijët e Selemes?” Ata thanë: “el-Xhed ibn Kais, edhe pse ne e kritikojmë atë për koprraci.” Pejgamberi tha: “Dhe cila e metë mund të jetë më serioze se koprracia!?”

Në një tjetër version të hadithit të mësipërm, Pejgamberi është transmetuar të ketë thënë:

“Vërtet, asnjë udhëheqës s'bën të jetë koprrac, por udhëheqës i juaj është el-Ebjedh el- Xhe'ed el-Bera' ibn Me'rur”

Ngjashëm, ajo çka Xhabir ibn Abdullahu i tha Ebu Bekr Sidikut (Allahu qoftë i kënaqur me të):

“Ti ose mund të më japësh, ose mund të jesh dorështrënguar” Ebu Bekr tha: “A nuk thua: ose mund të më japësh, ose mund të jesh dorështrënguar?! Dhe cila e

metë është më e madhe se koprracia?!”

Ebu Bekr, sikurse Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) e konsideroi koprracinë të jetë sëmundja apo e meta më e rëndë.

Në Sahi Muslim, është transmetuar nga Sulejman ibn Rebi’a:

“Umeri ka thënë: “Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) bëri ndarjen e pronës, dhe unë thashë: ‘Pasha Allahun, të tjerët janë më meritore se këta (të cilëve u qe dhënë).’ Pejgamberi tha: ‘Ata më lanë që unë të zgjedh, ose do të më kërkonin në mënyrë të pahijshme dhe të egër, ose do të më quanin koprrac, dhe unë nuk jam koprrac.”

Pejgamberi këtu thotë: Ata më kanë kërkuar në mënyrë e cila s’është me vend, ashtu që nëse unë ju jap atyre, kjo do të jetë në rregull, por nëse nuk u jap, ata do të thonë “Ai është koprrac.” Kështu, ata më lanë që të zgjedh në mes dy të këqijave, dhe nuk më lanë zgjedhje tjetër: pyetja e pahijshme, ose të më quanin koprrac. Që ata të më quajnë koprrac është më e rënda prej të këqijave, ashtu që unë e zbrapsa të keqen më të madhe duke iu dhënë atyre.

## LLOJET E KOPRRACISË

Koprracia është kategori e përgjithshme përbrenda së cilës ka lloje të ndryshme – disa janë mëkate të mëdha, dhe disa s’janë mëkat të mëdha. Allahu ka thënë:

Le të mos mendojnë ata të cilët qenë dorështrenguar me atë çka Allahu u dha atyre prej të mirave të Tij, se kjo është e mirë për ta. Madje, kjo është shumë keq për ta. Ajo e mirë me të cilën ata qenë dorështrenguar, në ditën e Kijametit do t’u mbështillet rreth qafave të tyre”. (Kur’an 3:180)

Adhurojeni Allahun dhe mos shoqëroni asgjë me Të, dhe bëhuni të sjellshëm ndaj prindërve tuaj... Vërtet Allahu nuk e do atë që është arrogant dhe mburravec, ata të cilët janë dorështrenguar dhe urdhërojnë të tjerët për koprraci. (Kur’an 4:36-37)

Dhe asgjë s’i parandaloi shpenzimet e tyre (të hipokritëve) që të pranohen përveç faktit se ata refuzuan besimin në Allahun dhe Pejgamberin e Tij. Ata e falin namazin më përtesë, dhe e shpenzojnë pasurinë e tyre me ngurrim dhe mospëlqim. (Kur’an 9:54)

Dhe, kur Ai u dha atyre prej të mirave të Tij, ata u treguan dorështrenguar me të dhe u kthyen prapa duke refuzuar. Dhe kështu, Allahu caktoi për ta hipokrizi pas kësaj në zemrat e tyre deri në ditën kur ata do ta takojnë Atë. (Kur’an 9:76-77)

Kushdo që bën koprraci, ai bën kundër vetes. (Kur'an 47:38)

Mjerë ata që falen\* Dhe janë të pakujdesshëm ndaj namazeve të tyre\* Ata të cilët vetëm falen që të shihen nga njerëzit, dhe të cilët madje nuk japin as sendet më të vogla. (Kur'an 107)

Sa u përket atyre të cilët e grumbullojnë pasurinë e tyre të arit dhe argjendit, dhe nuk e shpenzojnë atë në rrugë të Allahut, ata t'i paralajmërosh për një dënim të dhimbshëm. Në ditën kur ajo (ari dhe argjendi) do të nxehen në zjarret e Xhehenemit, dhe me të do të damkosen në pjesët e përparme, anët e tyre, dhe në shpinat e tyre, (dhe atyre do t'u thuhet:) Kjo është ajo që e keni grumbulluar për vete. Pra, shijoni atë që e grumbulloni. (Kur'an 9:34-35)

Ka shumë ajete në Kur'an të cilat urdhërojnë dhënien, shpenzimin dhe bujarinë, ndërsa kritikojnë këdo që i neglizhon këto, dhe tërë kjo është kritikizëm i koprracisë.

## KRITICIZMI I FRIKËS

Në Kur'an, kriticizmi që Allahu i bën frikës po ashtu gjendet në shumë ajete tjera, siç është në këto që vijojnë:

Dhe kushdo që ua kthen shpinën atyre (armikut në luftë) në atë ditë (të betejës) përveç si manovrim luftarak, apo që të rigrupohet me luftëtarët tjerë, ai është kthyer me një hidhërim të madh nga Allahu, dhe vendbanimi i tij është zjarri; sa përfundim i keq është ai. (Kur'an 8:16)

Dhe ata (hipokritët) betohen në Allahun se janë me ty, por ata s'janë me ty. Madje, ata janë njerëz që frikësohen (që t'i kundërshtojnë haptazi besimtarët)\* Sikur të gjenin ndonjë vend që të fshiheshin, ata do të shkonin në të me nxitim (për shkak të intensitetit të urrejtjes së fshehur të tyre ndaj Islamit dhe Muslimanëve) (Kur'an 9:56- 57)

Kur u zbrit kapitulli i qartë dhe në të përmendej lufta, ti mund t'i shohësh ata në zemrat e të cilëve ka sëmundje duke të shikuar sikur ai i cili është në grahamat e vdekjes. (Kur'an 47:20)

A nuk i ke parë ata të cilëve u është thënë: “Mos u bëni të dhunshëm, faleni namazin, dhe jepni Zekatin?” Dhe atëherë, kur lufta që bërë e detyrueshme për ta, vë re, disa prej tyre u frikësoheshin njerëzve ashtu siç duhet t'i frikësohen Allahut apo edhe më shumë. Ata thonë: “Zoti ynë, pse e ke bërë luftën detyrë për ne? Vetëm sikur të na e kishe shtyrë afatin për pak kohë!” Thuaj: “Furnizimi i kësaj jete të ulët është i paktë, dhe Jeta e Përtejme është më

e mirë për ata që kanë devotshmëri, dhe ju nuk do të keqtrajtoheni dhe as që do t'ju bëhet e padrejtë. (Kur'an 4:77)

Në çdo ajet në Kur'an në të cilin Allahu i nxit besimtarët në xhihad, dhe e sqaron dëshirën e tij, dhe ashpër kritikon ata të cilët e kthejnë shpinën dhe e neglizhojnë atë; e tërë kjo përbën dënimin e frikës.

## ÇËSH TJET E NJERËZVE NUK DO TË SHKOJNË NË RREGULL, PËRVEÇ ME GUXIM DHE BUJARI

Meqë reforma e çështjeve njerëzore, në këtë botë dhe në tjetrën, s' do të përsoset përpos me praninë e guximit dhe bujarisë, Allahu na e ka sqaruar neve se kushdo që ia kthen shpinën guximit – duke dështuar në përpjekjen në rrugë të Allahut – do të zëvendësohet nga të tjerët të cilët do t'i përmbushin detyrat e tyre. Dhe kushdo që e kthen shpinën nga shpenzimi i pasurisë së tij në rrugë të Allahut, do të zëvendësohet me të tjerë të cilët do t'i përmbushin detyrat e tyre. Allahu ka thënë:

O ju që besoni, ç'është me ju që kur thirrëni për luftë në rrugë të Allahut, ju bëheni të rëndë, të ngjitur për toke? A jeni të kënaqur me jetën e kësaj bote dhe e preferoni atë mbi Jetën e Përtejme? Vërtet, furnizimi i kësaj jete është i paktë në krahasim me Jetën e Përtejme. Nëse ju nuk dilni (në luftë), Allahu do t'ju dënojë me një dënim të dhimbshëm, do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, dhe ju s' do ta dëmtoni Allahun aspak. Allahu ka mundësi për çdo gjë. (Kur'an 9:38-39)

Ju jeni ata që thirrëni për të shpenzuar në rrugë të Allahut, e kush prej jush bën koprraci, ai bën kundër vetes. Allahu është i pasur, pa kurrfarë nevojë, ndërsa ju jeni të varfrit. Nëse ju e ktheni shpinën, Allahu do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, dhe ata s' do të jenë sikur ju. (Kur'an 47:38)



Ishte guximi dhe bujaria me të cilën Allahu i favorizoi “ata që erdhën para jush” (es- Sabikun), duke thënë:

Ata s’janë të njëjtë; ata nga ju të cilët shpenzuan (në rrugë të Allahut) dhe luftuan e u përpoqën para fitores – këta kanë shpërblim më të madh se ata të cilët e shpenzuan pasurinë e tyre dhe luftuan pas kësaj, dhe secilit prej tyre, Allahu u ka premtuar të mira. (Kur’an 57:10)

Allahu e ka përmendur xhihadin me jetën dhe pronën e njeriut në rrugën e Tij, dhe i ka lavdëruar ata në shumë ajete të Librit të Tij. Ky është guxim dhe vetëpërmbajtje në bindje ndaj Allahut. Allahu thotë:

Sa e sa grupe të vogla i kanë mundur grupet e mëdha me lejen e Allahut? Allahu është me ata që kanë durim. (Kur’an 2:249)

O ju që besoni, bëhuni të qëndrueshëm kur ta takoni armikun dhe përkujtoni Allahun shumë, ashtu që të arrini sukses. Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, dhe mos u përçani e ta shkaktoni disfatën tuaj, dhe ta humbni guximin. Bëhuni durimtarë. Vërtet Allahu është me ata që janë durimtarë. (Kur’an 8:46)

## Ç'ËSHTË GUXIMI?

Guximi s'është forcë e trupit. Njeriu mund të jetë i fortë fizikisht, por i dobët në zemër. Më saktë, guximi është forcë e zemrës dhe vendosmëri e saj. Faktorët vendimtarë në luftë janë forca fizike, shkathtësia në luftë, dhe guximi e qëndrueshmëria e zemrave të luftëtarëve.

Guximi i vetëm i cili është i lavdërueshëm, është guximi i bazuar në dituri dhe informata, jo ashpërsia e thjeshtë, pa mendim apo dallim në mes veprave të lavdëruara dhe të dënuara. Për këtë arsye, i fortë dhe i aftë, siç definohet nga Islami, është ai i cili mund ta kontrollojë veten në hidhërim, ashtu që ai bën vetëm atë që është vërtet e dobishme. Për sa i përket atij i cili kaplohet nga hidhërimi i tij, ai s'është as guximtar as i aftë.

## KTHIMI NË DURIM DHE LLOJET E TIJA

Siç kemi thënë, çelësi për në forcën e mirëfilltë është durimi, dhe kjo është një element i domosdoshëm. Durimi është dy llojesh: durimi në hidhërim dhe durimi në fatkeqësi. el- Hasan (el-Basri) ka thënë:

“Asnjë rob i Allahut nuk ka dhënë goditje më efektive sesa urtësia dhe vetëpërmbytja në hidhërim, dhe durimi përballë fatkeqësisë.”

Kjo sepse elementi i përbashkët në të gjitha këto gjëra është durimi në atë që është e dhimbshme. Guximtar dhe i aftë është ai i cili mund të bëjë durim dhe të ngulmojë përkundër dhimbjes.

Diçka e dhimbshme – nëse është diçka e cila mund të largohet – shkakton hidhërim. Dhe, nëse është diçka që s’mund të largohet, ajo shkakton pikëllim (huzn). Për këtë shkak fytyra skuqet nga hidhërimi, ndërsa gjaku vlon për shkak të ndjenjës së fuqisë dhe mundësisë për të shkatërruar atë që e shkakton hidhërimin, dhe fytyra zbehet dhe bëhet e pagjak në pikëllim, ndërsa gjaku tërhiqet për shkak të ndjenjës së dobësisë dhe pamundësisë që të bëjë ndonjë gjë në lidhje me shkakun e pikëllimit.

Kështu, Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) i bashkoi të dy llojet e durimit në hadithin sahi vijues që gjendet në koleksionin e Muslimit:

“Pejgamberi ka thënë: “Si e përcaktoni er-Rekub (pa fëmijë) në mesin tuaj?” Ata thanë: “er-Rakub është ai të cilit nuk i ka lindur asnjë fëmijë.” Pejgamberi tha: “Kjo s’është er- Rakub. er-Rakub është ai i cili nuk e ka sakrifikuar ndonjë prej fëmijëve të tij (në rrugë të Allahut).” Pastaj, Pejgamberi tha: “Dhe cilin e konsideroni të pathyeshëm (apo “të madh”) në mesin tuaj?” Ata thanë: “Atë të cilin njerëzit s’mund ta mbizotërojnë apo ta mposhtin.” Pejgamberi tha: “Nuk është kështu. I madh është ai i cili mund ta kontrollojë veten në hidhërim.”

Në këtë hadith, Pejgamberi përmendi atë e cila përfshin durimin përballë fatkeqësisë (humbjen e djemve në luftë në rrugën e Allahut). Dhe durim në hidhërim. Allahu ka thënë në lidhje me fatkeqësinë në përgjithësi:

“Dhe përgëzoji durimtarët\* Ata që, kur dëmtohen me ndonjë fatkeqësi, thonë: “Vërtet, prej Allahut kemi ardhur, dhe te Allahu do të kthehem.”

Dhe Allahu tha në lidhje me hidhërimin:

Veprat e mira dhe veprat e këqija s’janë të njëjta. Largoje të keqen me atë që është e mirë. Papritmas, ai me të cilin keni pasur armiqësi bëhet i afërt sikurse shoku i devotshëm\* Dhe askush s’do ta arrijë këtë, përveç atyre që janë durimtarë; dhe asnjë s’do ta arrijë këtë, përveç atyre që janë fatlumë. (Kur’an 41:34-35)

Ky parashtrim i elementeve të përbashkëta në mes durimit përballë fatkeqësisë, dhe durimit në hidhërim është e ngjashme me përmendjen e elementeve të përbashkëta në mes durimit në fatkeqësi dhe durimit në bollëk dhe rehati si në ajetin vijues:

Dhe nëse Ne e bëjmë njeriun që të shijojë mëshirën Tonë, dhe pastaj e marrim atë prej tij, vërtet, ai bëhet i dëshpëruar dhe jofisnik. Dhe nëse Ne e bëjmë atë që të shijojë bollëkun pas disa fatkeqësive, të cilat e kishin goditur atë, vërtet, ai do të thotë: E keqja më la. Vërtet, ai është gazmor, arrogant. Të gjithë përveç atyre që janë durimtarë dhe bëjnë vepra të mira. Për këta ka falje dhe shpërblim të madh. (Kur’an 11:9-11)

Me qëllim që ju mos të dëshpëroheni për atë që nuk e keni, e as të jeni (tepër) të lumtur për atë që ju është dhënë. (Kur'an 57:23)

Më këtë cilësi, poeti Ka'ab ibn Zuheir i përshkruajti Migruesit në mesin e Shoqëruesve (Sahabëve) (Allahu qoftë i kënaqur me ta) duke thënë:

“Ata nuk ishin tepër të lumtur kur shpatat e tyre goditnin kundërshtarët e tyre, e as që ishin të dëshpëruar kur ata vetë goditeshin.”

Një tjetër poet, Hasan ibn Thabit ka thënë në përshkrimin e Ensarëve (Ndihmuesve):

“Nuk ka mburrje nëse ata u shkaktojnë dëm armikut të tyre, dhe nuk ka plogështi dhe pakënaqësi nëse ata vetë dëmtohen.”

Disa Arabë thonin për Pejgamberin:

“Kur ai është fitimtar, s’është mburravec, dhe kur ai pëson disfatë, s’është i pikëlluar.”

## NDALIMI I TEJKALIMIT TË KUFIJVE

Meqë shejtani thërret njerëzit, gjatë këtyre dy llojeve të situatave, që të shkelin kufijtë e vendosur nga Islami me zemrat e tyre, zërat, dhe duart, Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) e ka ndaluar këtë në hadithin vijues:

I është thënë Pejgamberit, kur ai qe parë duke quajtur kur e pa të birin e tij Ibrahimin të përgatitur për varrim: “A qan ti, ndonëse ti e ke ndaluar të qarët dhe vajtimin për të vdekurin?” Pejgamberi tha: “Atë që unë e kam ndaluar s’është tjetër pos dy zërave të turpshëm, idiotik: njërin zë në kohë të bollëkut dhe rehatisë: mendjelehtësia, loja, dhe fyelli i Shejtanit (d.m.th.muzikën); dhe zërin tjetër në kohë të fatkeqësisë: goditja e faqeve (fytyrës), shqyerja e teshave, dhe thirrja me thirrje të Xhahilijetit (inJORANCËS) (thirrjet për hakmarrje apo kërkimi i së keqes për dikë bazuar në nacionalizëm apo tribalizëm) në të cilin Pejgamberi ka përmendur të dyja në hadithin e njëjtë. Në një hadith tjetër, ai e ndalon atë vetëm në lidhje me fatkeqësi:

“Kushdo që i godet faqet dhe shqyen teshat dhe thërret me thirrje të xhahilijetit, s’është prej neve.”

Dhe, në një hadith tjetër:

“Unë jam i pafajshëm për (mëkatën e) atij që e rruan kokën e tij, atij që vajton, dhe atij që i shqyen teshat e tija (d.m.th. ai që i bën këto gjëra kur të goditet më fatkeqësi.)”

“Vërtet, Allahu nuk e merr askënd në llogari për lotin e syrit, e as për pikëllimin e zemrës, por Ai dënon apo mëshiron bazuar në këtë. (Duke e thënë këtë, ai tregoi nga gjuha e tij).”

“Për këdo që njerëzit qajnë dhe vajtojnë, ai dënohet për shkak të qarjes dhe vajtimit të tyre.” (Ky hadith, dhe të gjitha para tij në këtë seksion janë prej Buharit)

Njëra prej kushteve të kërkuara nga femrat në Zotimin e Besnikërisë ishte ajo se ato duhej të pajtoheshin që kurrë mos të qanin apo vajtonin për të vdekurin, dhe ai tha:

“Vërtet, gruaja e cila qan dhe vajton për të vdekurin, nëse ajo nuk pendohet para vdekjes së saj, do të veshët në Ditën e Kijametit me jelek të lungave dhe me fustan prej katranit të shkrirë.”

Pejgamberi përmendi dy zërat idiotikë dhe të turpshëm: zëri i cili sjell shkelje (të kufijve) në lumturi ashtu që personi bëhet “gazmor dhe arrogant” (farihun fekhur), dhe zëri tjetër në kohë të pikëllimit i cili sjell padurim dhe dëshpërim, ashtu që personi bëhet “i pakënaqur dhe i paduruar” (halu’an xhezu’an).

Për sa i përket zërit i cili zgjon hidhërim për hir të Allahut, siç është britma e luftës dhe poezia e cila është e kompozuar për xhihad, kjo kurrë s’është bërë më instrumente muzikore. Ngjashëm janë edhe zërat për përhapjen e lajmit në festimet martesore. Këto dyja janë lejuar, dhe janë liruar nga vendimi i përgjithshëm me Sunet të Pejgamberit: bërtitma dhe poemat e betejës, rrahja e defit (pa byzylyk) në ahengjet martesore, dhe festimet

për gra dhe fëmijë.

Normë e poetëve është ajo se ata pasojnë natyrën njerëzore, siç ka thënë Allahu:

A nuk sheh se ata janë në çdo luginë, duke bredhur paqëllim?\* Dhe atë se ata e flasin atë që nuk e punojnë? (Kur'an 26:225-226)

Për këtë arsye, Allahu na informon se poetët pasohen nga ghavun (njëjës: ghau). Ghau është ai i cili pason epshin e vet pa dituri dhe pa udhëzim, dhe kësaj i referohet si ghej. Personi i tillë s'është i udhëzuar (muhtedi), mu ashtu si ai i cili është shmang apo "humbur" (dhall), është ai i cili nuk e njeh atë që i bën dobi atij, prapë në kontrast me atë në udhëzim. Allahu ka thënë:

Pasha yllin kur perëndon\* Shoku juaj nuk ka humbur (dhall), e as që është shmang (prej ghej). (Kur'an 53:1-2)

Dhe, për këtë arsye, Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) ka thënë:

"Ajo që ju takon është (pasimi i) çfarëdo që ju vjen prej traditës (sunsetit) tim, dhe traditës së të hershmëve, pasardhësve të udhëzuar drejt; shtrëngojuni në këtë më dhëmballët tuaja!"

Kështu ne i gjejmë ata (poetët) duke i lavdëruar të gjitha llojet e trimërisë dhe vetëpërmbajtjes, meqë mangësia e këtyre cilësive është e dënueshme në çdo situatë. Për sa i përket pranisë së këtyre cilësive, kjo do të sjellë arritjen e asaj çka uni dëshiron, çfarëdo qoftë ajo, por dobia



përfundimtare është vetëm për të devotshmit. Për sa u përket të paditurve, ata do të kenë dobi në staza të shkurta (d.m.th. në këtë jetë), por jo edhe në përfundim (Në Jetën e Përtejme).

“Dobia përfundimtare”, ndonëse përfundimisht është në Jetën e Përtejme, po ashtu mund të jetë edhe në këtë jetë, siç ka thënë Allahu pasi që ka përmendur rrëfimin e Nuhut, dhe shpëtimin e tij në barkë:

Qe thënë: O Nuh, zbrit poshtë (prej barkës) me paqe prej nesh dhe bekimet mbi ty dhe mbi njerëzit tjerë (të cilët do të vijnë) prej teje. Dhe njerëzve tjerë ne do t’u japim kënaqësi (për një kohë) pastaj do t’i tronditim me një dënim të dhimbshëm\* Këto janë disa nga rrëfimet e të padukshmes, të cilat Ne t’i kemi shpallur ty. As ti e as njerëzit tu nuk e kanë ditur këtë para kësaj. Pra, bëni durim. Vërtet dobia përfundimtare është për të devotshmit. (Kur’an 11:48-49)

Dhe kushdo që ju sulmon, edhe ju sulmoni ata në masë të njëjtë në të cilën ata ju sulmuan, dhe kini frikë Allahun, se vërtet Allahu është me ata që i frikësohen Atij. (Kur’an 2:194)

## ENTUZIAZMI DHE GUXIMI QË ËSHTË I LAVDËRUESHËM

Kriteri këtu është se entuziazmi dhe guximi i vetëm i cili është i lavdërueshëm, është ai i cili është lavdëruar nga Allahu dhe Pejgamberi i Tij (salallahu alejhi ue selam). Allahu është Ai, lavdërimi i të Cilit është bukuri dhe kritika e të Cilit është çnderim, dhe kjo s'është për asnjë tjetër pos për Allahun, as për poet, as për orator, apo ndonjë tjetër.

Kështu, kur një Arab nga fisi i Beni Temimit i tha Pejgamberit (salallahu alejhi ue selam) "Lavdërimi im është zbukurim, ndërsa kritika ime është poshtërim", Pejgamberi i tha atij: "Kjo është për Allahun!".

Allahu e ka lavdëruar guximin dhe vetëpërmbajtjen në rrugën e Tij, s'i në sahinë të transmetuar nga Ebu Musa el-Esh'ari (Allahu qoftë i kënaqur me të):

I është thënë Pejgamberit: Njeriu mund të luftojë prej trimërisë, dhe ai mund ta luftojë prej entuziazmit dhe eksitimit, dhe ai mund të luftojë që të shihet nga të tjerët, pra, cili nga këta është (vërtet) në rrugë të Allahut? Pejgamberi tha: Kushdo që Lufton që fjala e Allahut të jetë më e larta është në rrugë të Allahut."

Mu ashtu siç ka thënë Allahu:

Dhe luftoni ata derisa të mos ketë më kaos dhe mosmarrëveshje, dhe i tërë adhurimi të jetë vetëm për Allahun. (Kur'an 8:39)

Kjo, në fakt, është qëllimi për të cilin Allahu e ka krijuar njerëzimin, ashtu siç Ai ka thënë:

Dhe Unë nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzimin për tjetër, përveç që ata të më adhurojnë. (Kur'an 51:56)

Çfarëdo akti i cili është në kërkim të qëllimit të përgjithshëm për të cilin është krijuar i tërë krijimi, është i lavdërueshëm në shikimin e Allahut; dhe është ajo e cila ka ca dobi të mbetur për vepruesin e këtij akti, dhe Allahu do t'i bëjë dobi atij për shkak të kësaj. Këto pra janë veprat e mira (el-a'mel es-Salihah) të cilave u referohet në Kur'an. Në lidhje me këtë, njerëzit mund të ndahen në katër kategori:

Ata të cilët përpiqen dhe punojnë për hir të Allahut me guxim dhe vetëpërmbytje. Këta janë besimtarët të cilët e meritojnë shpërblimin e Parajsës.

Ata të cilët përpiqen dhe punojnë për tjetër pos Allahut me guxim dhe vetëpërmbytje. Këta përfitojnë nga veprat e tyre në këtë jetë, dhe s'ka gjë nga ajo për ta në Jetën e Përtejme.

Ata të cilët punojnë për Allahun, por pa guxim dhe pa vetëpërmbytje. Këta kanë një element të hipokrizisë (nifakut) dhe mangësi në besim (iman) deri në shkallën e frikës dhe pakënaqësisë së tyre.

Ata të cilët s'punojnë për Allahun, dhe s'kanë guxim dhe vetëpërmbytje. Këta nuk kanë pjesë as në këtë botë as në Jetën e Përtejme.

## **KARAKTERI PËR TË CILIN KA NEVOJË BESIMTARI**

Këto cilësi dhe këto vepra janë të nevojshme për besimtarin në përgjithësi, dhe në veçanti në kohë të kaosit, konfliktit, dhe sprovave të mëdha. Ata kanë nevojë për reformim të plotë të vetes së tyre, përkundër pranisë së asaj përbrenda tyre e cila thërret në kaos dhe çoroditje. Dhe ata po ashtu kanë nevojë që të përmbushin detyrat e tyre me anë të urdhërimit të të tjerëve në atë që është e mirë dhe ndalimit të tyre prej asaj që është e keqe aq sa kanë mundësi. Të dyja këto detyra përmbajnë vështirësi të mëdha siç kemi parë, ndonëse janë të lehta për ata për të cilët Allahu i ka bërë ato të lehta.

Kjo sepse Allahu i ka urdhëruar besimtarët që të kenë besim dhe të bëjnë vepra të mira, dhe i ka urdhëruar ata që t'i thërrasin njerëzit dhe të përpiqen me ta që të sjellin besimin dhe praktikimin e veprave të mira. Dhe Allahu u ka premtuar atyre ndihmën e Tij në këto aktivitete. Allahu ka thënë:

Dhe Allahu me siguri do t'i ndihmojë ata të cilët e ndihmojnë Atë (d.m.th. kauzën e Tij), dhe vërtet Allahu është i fortë, i fuqishëm. Ata të cilët, nëse Ne ju japim autoritet në tokë e falin namazin, paguajnë zekatin, urdhërojnë në tërë atë që është e mirë. Dhe tek Allahu është përfundimi i të gjitha çështjeve. (Kur'an 22:41)

Vërtet, Ne do t'i përkrahim Pejgamberët Tanë dhe ata që besojnë në jetën e kësaj bote, dhe në ditën prezantimit të

dëshmitarëve. (d.m.th. në Ditën e Gjykimit) (Kur'an 40:51)

Allahu ka shpallur dekret: Unë dhe Pejgamberët e Mi do të jemi fitimtarë. Vërtet, Allahu është i fuqishëm, që ka mundësi për çdo gjë. (Kur'an 58:21)

Vërtet, forcat tona do t'i mposhtin ata. (Kur'an 37:173)

## **FRIKA PREJ RËNIES NË SPROVË SI ARSYETIM PËR NEGLIZHIMIN E URDHËRIMIT PËR TË MIRËN**

Urdhërimi për të mirën dhe ndalimi i së keqes, dhe luftimi në rrugë të Allahut (xhiahadi) përmban teste dhe sprova të rënda në të cilat njeriu i eksponohet rrezikut të dorëzimit ndaj sprovave të llojeve të ndryshme. Për këtë arsye, paraqitet një grup nga mesi i njerëzve, të cilët përmendin frikën e tyre ndaj këtyre sprovave si arsyetim për shmangien prej asaj që u është bërë e detyrueshme, duke pohuar se ata vetëm kërkojnë sigurim nga këto sprova. Mu ashtu siç ka thënë Allahu për hipokritët:

Nga mesi i tyre është ai i cili thotë: Më fal, dhe mos më ekspozoj ndaj sprovave. Por vërtet, ata tashmë kanë rënë në sprovë. (Kur'an 9:49)

Dijetarët e tefsirit (Interpretimit Kur'anor) kanë përmendur se ky ajet që shpallur në lidhje me një njeri të quajtur el-Xhed ibn Kais kur Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) e urdhëroi atë që të përgatitet për betejën e Rrumit (Romakëve). Unë besoj se Pejgamberi më tha: A ke ndonjë problem me gratë e njerëzve të bardhë? el-Xhed tha: O Pejgamber, nuk ka njeri më të magjepsur me gra se unë. Pejgamberi e kthej fytyrën e tij prej el- Xhedit dhe tha: "Unë nuk shoh ndonjë arsyetim për ty." (Prej Sirës së Ibn Hishamit)

Ky njeri është po i njëjti i cili dështoi që të bëjë Betimin të njohur si Bei'tul Ridhvan, të cilën Shoqëruesit ia dhanë Pejgamberit nën një lis (pak para armëpushimit të Hudejbijes), dhe u fsheh pas një deve të kuqe. Në një hadith Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) ka thënë:

“Të gjithëve nga ju u janë falur mëkatet, përveç njeriut të devesë së kuqe.”

Dhe kështu, Allahu e shpalli ajetin e mësipërm në lidhje me këtë njeri, duke thënë:

Në mesin e tyre është ai i cili thotë: Më fal, dhe mos më ekspono ndaj sprovave. Por vërtet, ata tashmë kanë rënë në sprovë. (Kur'an 9:49)

Këtu, Allahu thotë: Ky njeri ka kërkuar që të mbetet prapa për ta shpëtuar veten nga sprova e grave, vetëm që të mos iu nënshtrohet sprovave për shkak të tyre: ose ai ka nevojë që t'i luftojë tendencat e tija të lindura, dhe të vuaj për shkak të konfliktit të brendshëm të tij, ose mund t'ju dorëzohet epsheve të tija dhe të mëkatojë. Kushdo që e sheh ndonjë figurë shumë të mirë dhe e dëshiron atë – nëse ai s'ka mundësi që t'i plotësojë dëshirat e tija – qoftë për shkak të ndalimit ligjor, apo për shkak të paaftësisë së tij, përjeton vuajtje në zemrën e tij. Nëse ai ka mundësi ta marrë atë, edhe pse ajo është e ndaluar, ai është i shkatërruar, dhe madje edhe në të lejuarën e saj d.m.th. bashkëveprimin me femër, ka kurthe të rrezikshme.

Kjo është domethënia e thënies së el-Xhedit: “...dhe mos më ekspono ndaj sprovave.” Dhe kështu, Allahu ka thënë: Vërtet, ata tashmë kanë rënë në sprovë. d.m.th., thënia:

Mu largimi i tij nga detyra e xhihadit, dhe tërheqja e tij prej tij (xhihadit), dhe dobësia e besimit të tij, dhe sëmundja e zemrës së tij e cila e bëri përpjekjen e tij për t'iu shmangur xhihadit të duket e mirë dhe e pranueshme, është një sprovë e madhe në të cilën ai tashmë ka rënë. Meqë ky është rasti, si mundet ai që të kërkojë shkarkim nga sprovat e vogla, të cilat ende nuk e kanë goditur atë, duke iu dorëzuar një sprove më të madhe e cila tashmë ka ndodhur? Allahu ka thënë:

Dhe luftoni ata derisa të mos ketë më kaos dhe e tërë feja të jetë vetëm për Allahun. (Kur'an 9:21)

Pra, kushdo që i shmanget luftimit të cilin Allahu e ka urdhëruar, vetëm që mos t'u eksponohet sprovave, tashmë ka rënë në sprovë, për shkak të dyshimit dhe sëmundjes e cila gjendet në zemrën e tij, dhe neglizhimit të tij të xhihadit në të cilin Allahu e ka urdhëruar atë.

Mendoni për këtë me kujdes, sepse kjo është një pyetje e rrezikshme. Njerëzit, në lidhje me këtë, ndahen në dy kategori:

Njëri grup urdhëron, ndalon, dhe lufton në rregull, ashtu siç e imagjinojnë ata, që t'i largojnë kaosin dhe sprovat. Veprat e tyre janë një kaos apo sprovë edhe më e madhe se ajo të cilën ata përpiqen ta largojnë. Ky është shembulli i atyre që nxitojnë të luftojnë në konfliktet të cilat shfaqen në mesin e Muslimanëve, siç janë havarixhët.

Grupi tjetër e lë urdhërimin për të mirën dhe ndalimin prej të keqes dhe luftimin në rrugë të Allahut me të cilën feja bëhet vetëm për Allahun, dhe që fjala e tij të jetë më e



larta, me qëllim që t'i shmangen sprovës. Ata tashmë i janë dorëzuar sprovës dhe kanë rënë në të.

Sprova e cila përmendet në ajetin e mësipërm përfshin sprovën e fytyrave të bukura, meqë ajo është rrëfimi prapa shpalljes së ajetit. Në një kuptim më të përgjithshëm, ky është rasti me shumë njerëz të ashtuquajtur “fetarë”. Ata e lënë pas dore urdhërimin për të mirën dhe ndalimin prej të keqes, e cila është e detyrueshme për ta dhe luftimin në rrugë të Allahut me të cilin e tërë feja mund të jetë për Allahun, dhe me anë të së cilës fjala e Allahut bëhet më e larta, me qëllim që t'u shmangen sprovave dhe dëshirave të kësaj bote. Në të vërtetë, ata tashmë kanë rënë në sprovën e cila është shumë më e rrezikshme se e para, prej të cilës ata mendonin se janë duke ikur.

Ajo që u ka takuar atyre ishte që t'i përmbushin detyrat e tyre të urdhërimit për të mirën dhe ndalimit prej të keqes dhe të largohen nga e ndaluara. Largimi nga e ndaluara dhe përmbushja e detyrave janë dy anët e monedhës së njëjtë, meqë veta e tyre s'do t'u lejojë atyre ndonjë tjetër zgjedhje, përveç bërjes së të dyjave së bashku, apo lënies së të dyjave së bashku. Ky është rasti i atyre të cilët kërkojnë udhëheqësi dhe pronë apo dëshira të paligjshme: kurdo që ata përmbushin atë që u takon atyre më anë të urdhërimit dhe ndalimit, luftimit dhe sundimit dhe gjërave të këtilla, ata gjithmonë krahas kësaj bëjnë edhe akte të ndaluara. Ajo që u takon atyre në këtë pikë është që të analizojnë se cila prej dy elementeve është me e madhe. Nëse detyrat janë më të mëdha në shpërblim sesa shmangia nga e ndaluara, ata duhet të vazhdojnë, dhe të

mos i lënë detyrat të cilat ata janë duke i zbatuar nga frika prej rënies në një sprovë më të vogël. Në anën tjetër, nëse largimi nga e ndaluara që përfshihet është shpërblim më i madh, ata duhet s’duhet ta braktisin këtë shpërblim duke shpresuar në një shpërblim më të vogël në bërjen e detyrës së përfshirë. Në këtë kombinim të së mirës dhe së keqes ka një përzierje të së mirës dhe së keqes në llogarinë e tyre te Allahu. Një shpjegim i detajuar i këtij koncepti do të ishte tepër i gjatë.

## **ÇDO QENIE NJERËZORE KA NEVOJË PËR URDHËRIM DHE NDALIM**

Çdonjëri në faqen e dheut duhet prej domosdoshmërisë që të ketë urdhërim dhe ndalim. Është e domosdoshme që ai të urdhërohet dhe të ndalohej. Edhe sikur ai të ishte plotësisht vetëm, ai do të duhej që ta urdhërojë dhe ndalojë veten – ose në atë që është e mirë, ose prej asaj që është e keqe, siç ka thënë Allahu në lidhje me unin njerëzor:

Dhe, vërtet, uni përherë urdhëron (njeriun) që të bëjë keq. (Kur’an 12:53)

Urdhërimi në esencë është kërkimi i një veprimi të caktuar, dhe të pasurit për qëllim atë, derisa ndalimi është shmangia prej një vepre caktuar, dhe të pasurit për qëllim atë.

## BIJTË E ADEMIT NUK JETOJNË, PËRVEÇ NË SHOQËRI

Çdo gjë e gjallë duhet, prej nevojës, të shkaktojë qëllime dhe dëshira përbrenda vetes me të cilat ai (veta e tij) e përcakton veprën e vet, dhe me të cilat ai i përcakton veprat e të tjerëve kurdo që kjo të bëhet e mundshme për të. Vërtet, njeriu është send i gjallë, ai lëviz me vullnetin dhe qëllimin e tij, dhe qeniet njerëzore nuk jetojnë, përveç duke u bashkuar në grupe dhe duke jetuar më njëri-tjetrin.

Kurdo që dy apo më shumë veta bashkohen, ne mes tyre duhet, doemos, të ketë urdhërim të ndërsjellë të disa gjërave, dhe ndalim të ndërsjellë të gjërave tjera. Për këtë arsye, bashkësia më e vogël është prej dy vetash, dhe është thënë: dy njerëz apo më shumë e përbëjnë një “bashkësi” (xhemat), dhe meqë bashkimi i tyre është pikërisht për namaz, kjo plotësohet vetëm me dy, ku njëri është udhëheqës (imam), dhe tjetri udhëhiqet (me’ mum). Siç i tha Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) el-Melik ibn el-Huveirithit dhe shokut të tij:

“Kur të vijë koha e namazit, thirre ezanin dhe ikametin, dhe pastaj më i vjetri prej jush le të udhëheqë në namaz.” (Ka pasur të njëjtë në aftësi të leximit të Kur’anit.)

Për sa u përket çështjeve të rëndomta (të tjera pos namazit), është transmetuar në librat e hadithit se Pejgamberi ka thënë:

“Nuk është e lejuar për tre veta të cilët udhëtojnë, që ata të mos e zgjedhin njërin prej tyre emir (udhëheqës).”

## **KJO E URDHËRUAR DUHET TË JETË ME ATË TË CILËN E KA URDHËRUAR ALLAHU DHE PEJGAMBERI I TIJ**

Urdhërimi dhe ndalimi, nga domosdoshmëria janë të pranishme me praninë e qenieve njerëzore. Sidoqoftë, personi mund të dështojë në urdhërimin e së mirës të cilën e kanë urdhëruar Allahu dhe Pejgamberi i Tij (salallahu alejhi ue selam), dhe të ndalojë të keqen të cilën e kanë ndaluar Allahu dhe Pejgamberi i Tij, dhe të jenë të urdhëruar që të bëjnë të mirën të cilën e kanë urdhëruar Allahu dhe Pejgamberi i Tij, dhe të ndalohen prej të keqes të cilën e kanë ndaluar Allahu dhe Pejgamberi i Tij. Megjithatë, përherë do të ketë një lloj të urdhërimit dhe ndalimit, dhe të qenit i urdhëruar dhe të qenit i ndaluar. Kjo mund të jetë me atë e cila është e kundërt me të mirën dhe të keqen të cilën e kanë definuar Allahu dhe Pejgamberi i Tij, apo kjo mund të jetë me atë e cila përmban elemente të së vërtetës të cilën Allahu e ka zbritur, dhe të pavërtetës për të cilën Allahu s’ka zbritur kurrfarë autoriteti. Nëse kjo përzierje merret si mënyrë e jetës (fesë), kjo është fe e risisë, gënjeshtërisë, dhe shmangies. Dhe meqë, siç kemi treguar, çdo personi i gjallë jeton, vepron me vullnet të lirë, si një kërkues i synimeve, një “lërues i tokës”, qëllimet dhe veprat e

kujtdo qoftë që s'janë për hir të Allahut, duhet pashmangshëm të bëjë vepra të cilat janë të çoroditura, ose jo për hir të Allahut – dhe kjo është e pavërtetë dhe e pavlefshme. Siç ka thënë Allahu:

Vërtet, përpjekjet tuaja janë të ndryshme. (Kur'an 92:4)

Veprat e tilla, të gjitha prej tyre, janë të pavlefshme sikur veprat (sado qoftë të mira) të jobesimtarëve:

Ata të cilët e refuzojnë besimin, dhe pengojnë prej rrugës së Allahut, Allahu do t'i humbë të gjitha veprat e tyre. (Kur'an 47:1)

Sa u përket atyre që mohojnë, veprat e tyre janë sikur vegimi në një fushë të zbrazët. I eturi mendon se ajo është ujë, por kur e mbërrin atë, ai sheh se ajo është asgjë, dhe ai e gjen aty Allahun i cili do ta marrë atë në llogari, dhe Allahu është shumë i shpejtë në marrjen e llogarisë. (Kur'an 24:39)

Dhe ne i kthehemi tërë punëve të tyre të cilat ata i kanë bërë, dhe i bëjmë ato si pluhurin e shpërndarë. (Fjala saktësisht do të thotë pluhur i cili mund të shihet në ajër në rrezen e dritës e cila kalon nëpër një vrimë të vogël.) (Kur'an 25:23)

## KUSH JANË “PËRGJEGJËSIT NGA MESI JUAJ” TË CILËT URDHËROJNË PËR ATË QË ËSHTË E MIRË?

Allahu na ka urdhëruar neve në Librin e tij që t'i bindemi Atij, t'i bindemi Pejgamberit të Tij, dhe t'ju bindemi atyre në pushtet nga mesi i besimtarëve duke thënë:

O ju që besoni, bindjuni Allahut dhe bindjuni Pejgamberit të Tij, dhe atyre prej jush që janë pushtet. Dhe nëse ju s'pajtoheni për ndonjë çështje, parashtrojeni atë të Allahu dhe Pejgamberi, nëse ju vërtet besoni në Allahun dhe Ditën e Fundit. Kjo është më e mira, dhe do të ketë përfundimin më të mirë. (Kur'an 4:59)

**“Ata në pushtet”** janë: poseduesit e pushtetit dhe njerëzit e tij. Ata janë të cilët i urdhërojnë dhe i ndalojnë njerëzit. Kjo ndahet nga ata të cilët kanë pushtet politik dhe të përkohshëm, dhe njerëzit e diturisë dhe ndikimit intelektual.

Kështu, **“ata në pushtet”** përbëhen nga dy kategori: dijetarët dhe sunduesit. Kur ata janë të drejtë, njerëzit janë të drejtë, dhe kur ata janë të prishur, njerëzit janë të prishur. Mu ashtu siç Ebu Bekr (Allahu qoftë i kënaqur me të) i tha el-Ahmesijes kur ajo pyeti:

“Për sa kohë do të mbetemi ne në këtë gjendje të mirë?”  
Ebu Bekr tha: “Përderisa sunduesit e juaj të jenë të drejtë.”

Të këtij grupi janë edhe mbretërit dhe dijetarët, dhe njerëzit e fesë, së bashku me këdo i cili është i pasuar nga dikush, i cili po ashtu është në pozitë udhëheqëse në mesin tuaj.

Secilit prej këtyre i takon që të urdhërojë atë çka Allahu e ka urdhëruar, dhe të ndalojë atë çka Allahu ka ndaluar. Për më tepër, secili që është i urdhëruar në Islam që ta dëgjojë emirin e tij, apo të tjerët, duhet t'i dëgjojë ata në (tërë atë që është) bindje ndaj Allahut, dhe mos t'i dëgjojë ata në mosbindje ndaj Allahut. Ebu Bekr kur e mori Hilafetin tha:

“O njerëz, për sa më përket mua, i forti prej jush është i dobët përderisa unë të marrë atë që u takon të tjerëve prej tij (dhe t'ua japë atë poseduesve të vërtetë). Më dëgjoni, përderisa unë ta dëgjoj Allahun, dhe nëse unë nuk i bindem Allahut, atëherë s'kam kurrfarë të drejte në dëgjueshmërinë tuaj.”

## **QËLLIMI I PASTËR KËRKOHEM QË TË KËNAQET ALLAHU NË TË GJITHA VEPRAT E MIRA**

Të gjitha veprat e mira duhet të përmbajnë dy elemente vijuese: që ato të bëhen vetëm për hir të Allahut, dhe që ato të jenë në pajtim me sheriatin. Kjo vlen për të dyja, thëniet dhe veprat. Kjo është njëra prej kërkesave e të folurit të këndshëm dhe veprës së mirë, në çështjet e diturisë dhe të kuptuarit, si dhe në çështjet e zbatimit, adhurimit dhe devotshmërisë. Është transmetuar në një hadith sahi:

“Vërtet, tri kategoritë e para për të cilat Xhehenemi është ndezur janë: Njeriu i cili e ka mësuar diturinë dhe ua ka mësuar atë të tjerëve, dhe e ka lexuar Kur’anin dhe i ka mësuar të tjerët të lexojnë me qëllim që njerëzit të thonë: Ai është i dijshtëm, dhe ai është recitues i mirë. Dhe njeriu i cili ka luftuar dhe është përpjekur ashtu që njerëzit të thonë: Ai është guximtar, dhe ai është luftëtar i mirë. Dhe njeriu i cili e shpenzon atë që i është dhënë atij dhe ka dhënë lëmoshë vetëm për atë që njerëzit të thonë: Ai është bujar, ai është dorëhapur.”

Këto tri lloje njerëzish dëshirojnë shikime të mahnitura, reputacion dhe nderim. Ata janë në kundërshtim me tri llojet tjera të cilat janë përmendur në Kur’an pas Pejgamberëve: përherë të sinqertë dhe besimtarë (es-sidikin), martirët në rrugë të Allahut (esh-shuheda), dhe vepruesit e drejtë të së mirës (es-salihin).



Ai i cili mëson diturinë me të cilën Allahu i dërgoi Pejgamberët e Tij dhe e mëson atë krejtësisht për hir të Allahut, është njëri prej es-sidikinëve. Dhe, kushdo që lufton që fjala e Allahut të jetë më e larta derisa të vdes është njëri prej Esh-shuheda, derisa ai që e jep pronën e tij si lëmoshë duke dëshiruar me të vetëm Fytyrën e Allahut, është njëri prej es-Salihin.

Për këtë shkak, ai i cili i ka lënë pas dore detyrat në pronën e tij, do të kërkojë që të kthehet në çastin e vdekjes. Ibn Abas ka thënë:

“Kujtdo qoftë që i është dhënë pasuri, por nuk e ka bërë Haxhin, as nuk e ka paguar Zekatin për shkak të asaj pasurie, në çastin e vdekjes do të kërkojë që të kthehet.

**Pastaj, ai e lexoi ajetin e Kur’anit: Dhe shpenzoni nga ajo që Ne ju kemi dhënë para se t’i vijë vdekja ndonjërit prej jush, dhe të thotë: O Zoti im, vetëm sikur të më kishe dhënë pak afat që unë të jap lëmoshë dhe të jem prej bamirësve. (Kur’an 63:10)**

Pra, në këtë çështje të diturisë dhe retorikës, urdhëruesi për të mirën ka nevojë që të sigurohet se të gjitha informatat të cilat ai i tregon në lidhje me Allahun dhe Ditën e Fundit, dhe në lidhje me gjërat të cilat kanë qenë dhe janë, janë plotësisht korrekte. Po ashtu, ai duhet të sigurohet se çdo gjë që ai urdhëron në të tjerët dhe i ndalon ata është mu ashtu siç është sjellë nga pejgamberët e Allahut. Kjo është rruga e drejtë e cila është në pajtim me Sunetin dhe Sheriatin, dhe është rruga e pasimit të Librit të Allahut dhe Sunetit të Pejgamberit (salallahu alejhi ue

selam).

Mu ashtu si aktet e adhurimit, të cilat mirren si devocion – nëse ato janë prej atyre të cilat Allahu i ka urdhëruar, dhe Pejgamberi i Tij ka urdhëruar që të bëhet ashtu – janë valide dhe korrekte dhe janë në pajtim me porosinë me të cilën Allahu i ka dërguar pejgamberët. Në anën tjetër, aktet e “adhurimit” të cilat s’janë ashtu (d.m.th. s’janë pjesë e asaj çka Allahu dhe Pejgamberi i Tij kanë urdhëruar) janë të pavërteta, marrëzi, dhe risi (në fe) e cila të shmangë, ndonëse përkrahësit e saj mund ta quajnë atë: dituri, të kuptuar, devocion, ushtrime, përjetime, apo stacione/pozita.

Ai (urdhëruesi për të mirën) po ashtu duhet të urdhërojë vetëm për shkak të urdhrit të Allahut, të ndalojë vetëm për shkak të ndalesës së Allahut, dhe të informojë vetëm me atë me të cilën Allahu na ka informuar, sepse kjo është e vërteta, besimi i vërtetë, dhe udhëzimi, ashtu siç na kanë informuar Pejgamberët. Kjo, mu ashtu siç adhurimi i vërtetë kërkon që Fytyra e Allahut të jetë gjëja e vetme që synohet me të. Nëse ndonjë gjë prej kësaj bëhet nga pasimi i epshit, apo që të kërkohej reputacion dhe shikimi i mahnitur, kjo është sikur situata e atij i cili lufton nga guximi dhe pasioni, dhe në kërkim të shikimeve të mahnitura të të tjerëve.

Prej kësaj, ju mund të kuptoni atë në të cilën kanë rënë shumë njerëz të diturisë, ndikimit dhe të devocionit në adhurim dhe mirëqenie. Shumë njerëz të këtillë flasin shumë gjëra të cilat janë në konflikt me Kur’anin dhe Sunetin, apo atë e cila përmban disa elemente në pajtim

me Kur'anin dhe Sunetin dhe elemente të tjera në konflikt me to. Dhe shumë prej tyre iu përkushtohen akteve të "adhurimit" në të cilat Allahu kurrë s'i ka urdhëruar, dhe në të vërtetë, të cilat Ai i ka ndaluar, apo akte te devotshmërisë të cilat përmbajnë elemente të urdhëruara nga Allahu, dhe elemente të tjera të cilat kanë qenë ndaluar. Dhe shume prej tyre luftojnë në luftëra të cilat s'janë në pajtim me luftimin i cili është urdhëruar nga Allahu, apo i cili përmban elemente të urdhëruara nga Allahu, dhe elemente të tjera të cilat Ai i ka ndaluar.

Për më tepër, përbrenda secilës prej këtyre kategorive: të urdhëruara nga Allahu dhe Pejgamberi i Tij, të ndaluar, dhe kombinim i elementeve nga secili lloj, janë tri mundësi të qëllimeve nga ana e bërësit: qëllimi i pastër për hir të Allahut, pasimi i epshit personal, apo përzjerje e këtyre dyjave. Kjo përbën shumën e nëntë kategorive në fushën e qëllimit dhe validitetit të veprës.

Për sa i përket veprës së keqe në këto çështje, është e mundur që bërësi i tyre të jetë në gabim, apo thjesht të harrojë, në të cilin rast ato janë të falura, mu si në rastin e gjyqtarit i cili përpiqet ta arrijë vendimin korrekt, por gabon. Po ashtu, veprat e këqija mund të jenë mëkate të vogla (Sagha'ir) të cilat shlyhen me shmangien nga mëkatet e mëdha (kaba'ir), apo ai mund të falet përmes pendimit, apo me vepra të mira të cilat i fshijnë të këqijat, apo ato mund të jenë shlyer përmes fatkeqësive në jetë, apo për arsye tjera.

Megjithatë, feja (rruga) e Allahut me të cilën Ai dërgoi librat e shpallura dhe me të cilën Ai dërgoi pejgamberët,

është ajo çka thamë më parë: kërkimi i Allahut me vepra të mira (d.m.th. bindja ndaj Tij).

## **ALLAHU NUK PRANON PREJ NDONJËRIT TJETËR POS ISLAMIT**

Ky është koncepti i përgjithshëm i Islamit, tjetër pos së cilit Allahu s'do të pranojë prej ndonjërit. Allahu ka thënë:

Kushdo që dëshiron tjetër fe pos Islamit, ajo kurrë s'do të pranohet prej tij, dhe në Jetën e Përtejme ai është në mesin e të humburve. (Kur'an 3:85)

Allahu dëshmon se s'ka perëndi tjetër Përveç Tij, dhe engjëjt (po ashtu dëshmojnë) dhe dijetarët. Drejtësia e tij është e përsosur. Nuk ka zot përveç Atij, të fuqishmit, të urtit. Vërtet, rruga (feja) në shikimin e Allahut është Islami (nënshtimi) (Kur'an 3:18- 19)

## **DOMETHËNIET E ISLAMIT**

Koncepti i i Islamit përmban dy kuptime. I Pari është nënshtimi aktiv ndaj urdhërit të Allahut, dhe tjetra, që Muslimani të mos jetë arrogant dhe kryelartë. E dyta është sinqeriteti absolut, siç ka thënë Allahu:

...dhe njeriu plotësisht i poseduar nga Një. (Kur'an 39:29)

Pra, ai s'është i ndarë nga më shumë se një, dhe kjo është kur robi i dorëzohët plotësisht Allahut, Zotit të Botëve, siç ka thënë Allahu:

Dhe kush ia kthen shpinën traditës së Ibrahimit (teuhidit) përveç atij i cili është zhytur në marrëzi. Ne e kemi zgjedhur atë (Ibrahimin) në këtë botë, dhe në Jetën e Përtejme ai do të jetë në mesin e të drejtëve. Dhe kur Zoti i tij i tha atij: Nënshtrouhu, ai tha: Unë i jam nënshtruar Zotit të botëve! Dhe Ibrahim i këshilloi të birin e tij dhe kështu veproi edhe Jakubi me të (thënien): Bijë të dashur, vërtet Allahu ka zgjedhur për ju rrugën (fenë), pra ruajuni që mos të vdisni, përveç duke qenë të nënshtruar (në Islam) (Kur'an 2:130-132)

Thuaj: vërtet Zoti im më ka udhëzuar në rrugën e drejtë. Në rrugën e Ibrahimit, i cili ishte prej atyre që ishin me besim ta pastër dhe s'ishte prej idhujtarëve. Thuaj: Vërtet, namazi im, kurhani im, jeta ime, dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka ortak! Unë jam urdhëruar me këtë, dhe unë jam i pari prej Muslimanëve. (Kur'an 6:161-163)

Trajta foljore e derivuar nga Islami (aslama) nganjëherë paraqitet si folje jokalimtare, si në ajetet e mësipërme, dhe si në thënien e Allahut:

Dhe, kthehuni te Zoti juaj dhe nënshtroujuni Atij para se t'u vijë dënimi, dhe të mos ketë kush t'ju ndihmojë. (Kur'an 39:54)

Ajo (Belkisa, mbretëresha e Shebës) tha: Unë i kam bërë padrejt vetes! Dhe unë tash, së bashku me Sulejmanin, i

nënshtrohem Allahut, Zotit të botrave. (Kur'an 27:44)

A kërkojnë ata tjetër fe pos fesë së Allahut? Dhe Atij i është nënshtuar çdo gjë në tokë qiej dhe tokë, vullnetarisht dhe pa dëshirë, dhe Atij ata do t'i kthehen. (Kur'an 3:83)

Thuaj, a të lusim tjerë krahas Allahut? Gjëra të cilat as nuk bëjnë dobi e as dëm. Dhe të kthehemi prapa pasi që Allahu na ka udhëzuar? Sikur ai të cilin djajtë e posedojnë, dhe i hutuar brendh nëpër tokë. Ai ka shokë të cilët e thërrasin atë në udhëzim duke thënë: Eja tek ne. Thuaj, vërtet udhëzim është udhëzimi i Allahut, dhe ne jemi urdhëruar që t'i nënshtrohemi Allahut, Zotit të botave. (Kur'an 6:71)

Herëve tjera folja aslama (nënshtimi) paraqitet si folje kalimtare (me "fytyrën e njeriut" si objekt direkt) së bashku me konceptin e ihsanit (bamiresisë), si në thënien e Allahut:

Ata thanë: Askush s'do të hyjë në Parajsë, përveç Çifutit dhe të Krishterit. Këto janë shpresat e tyre. Thuaj: Silleni dëshminë tuaj nëse e thuani të vërtetën. Jo! Kushdo që ia nënshton fytyrën e tij Allahut dhe është muhsin (bamires), ai e ka shpërblimin e vet të Allahut. Për ta s'ka frikë, dhe ata nuk do të pikëllohen. (Kur'an 2:111-112)

Dhe kush është në rrugë me të mirë se ai i cili ia nënshton fytyrën e tij Allahut dhe është bamires, duke pasuar traditën e Ibrahimit (të teuhidit), dhe Allahu e zgjodhi Ibrahimin për mik. (Kur'an 4:125)

Allahu e ka refuzuar nocionin se mund të ketë ndonjë fe (rrugë) tjetër e cila është më e mirë se kjo rrugë. Dhe kjo është të nënshtruarit fytyrën Allahut me bamirësi (ihsan). Dhe Ai na informoi se cilido që ia nënshtron fytyrën e tij Allahut dhe është bamirës, e ka shpërblimin e tij të Allahu, dhe s'do të ketë frikë as pikëllim për të. Ai e vendosi këtë koncept gjithëpërfshirës dhe këtë pyetje të përgjithshme si kundërshtim ndaj atyre të cilët imagjinonin se askush s'do të hyjë në Parajsë, përveç atij që është besnik ndaj judaizmit apo Krishterimit.

## DOMETHËNIA E TË NËSHTRUARIT FYTYRËN ALLAHUT

Të dy konceptet e fundit: të nënshtruarit fytyrën Allahut, dhe bamirësia janë dy kërkesat e njëjta për pranimin e veprave të personit, e cila qe diskutuar më herët d.m.th. që vepra të bëhet me sinqeritet të plotë për hir të Allahut, dhe që ajo të jetë korrekte, në pajtim me sunetin dhe sheriatin. Kjo sepse të nënshtruarit fytyrën Allahut sjell vullnet dhe qëllim për hir të Allahut, siç thotë një poemë:

“Kërkoj falje prej Allahut për mëkatet të cilat s’mund t’i numëroj.” Zoti i robërve, për të është fytyra dhe vepra (e njeriut).”

Këtu janë përdorur katër fjalë të ndryshme: nënshtrimi i fytyrës së njeriut, të drejtuarit e fytyrës, dhe drejtimi i fytyrës (nga Allahu), si në thënien e Allahut:

Dhe drejtoni fytyrat tuaja në çdo namaz. (Kur’an 7:29)

Dhe drejtoje fytyrën tënde në rrugën (fenë) si një monoteist i pastër; rruga natyrore në të cilën Allahu e ka bërë njerëzimin. (Kur’an 30:30)

Dhe siç citohet Ibrahim (paqja qoftë mbi të) duke thënë:

Vërtet, unë e kam drejtuar fytyrën time nga Ai i cili shpiku qiejt dhe tokën, si një monoteist i pastër, dhe unë s’jam prej idhujtarëve. (Kur’an 6:79)

Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) thoshte të njëjtën



gjë në lutjen hyrëse të namazit të tij të natës:

“Unë e drejtoj fytyrën time nga Ai i cili shpiku qiejt dhe tokën, si një monoteist i pastër, dhe unë s’jam prej idhujtarëve.”

Në hadithin sahi, el-Bera ibn Azib rrëfen:

“Pejgamberi më mësoi të them para se të flej: “O Allah, unë e kam dorëzuar veten time te Ti, dhe e kam drejtuar fytyrën time nga Ti...”

Fjala për “fytyrë” në Arabishte, uexhh, mund të ketë domethënien e atij (i cili) e drejton veten (el-Muteuaxhih), dhe mund të ketë domethënien: ajo që është e drejtuar nga apo në drejtim të diçkaje (el-Muteuexheh Ilaihi, apo el-Muteuexhih Nehvehu). Siç është thënë: Cilin drejtim (uexhh, saktësisht: “fytyrë”) e do? d.m.th. në cilin drejtim apo anë synon të shkosh? Kjo sepse këto dy koncepte duhet të jenë së bashku, dhe janë përshëndetje. Kurdo që personi përballet me diçka, fytyra e tij po ashtu përballet me të njëjtën gjë, dhe fytyra e tij është parakusht i “të drejtuarit” të tij nga diçka. Ky është rasti në veprat e jashtme dhe të brendshme, dhe kjo i bën katër gjërat (d.m.th. ajo që është e drejtuar dhe ajo që drejton, secila prej tyre e jashtme dhe e brendshme). E brendshmja është origjina, ndërsa e jashtmjja është përmbushja dhe simboli. Kështu, kur njeriu e drejton zemrën e tij nga diçka, “fytyra” e tij e jashtme pason procesin.

Kur robi i Allahut e ka qëllimin dhe synimin e dëshiruar të tij që ta drejtojë veten nga Allahu, kjo është mirësia e vullnetit dhe qëllimit të tij. Nëse, në të njëjtën kohë ai është

bamirës, ai i ka arritur dy tiparet: se veprat e tija janë të mira dhe ai nuk shoqëron askënd në adhurim të Zotit të tij. (Shiko Kur'anin 18:110) Kjo, përsëri, është domethënia e lutjes së Umerit, i cili thoshte:

“O Allah, bëji të gjitha veprat e mia të mira, dhe bëri të gjitha ato krejtësisht për Fytyrën tënde, dhe mos bëj në këtë ndonjë pjesë për dikë tjetër.”

## DEFINICIONI I VEPRAVE TË MIRA

Vepra e mirë është bamirësia (ihsani, i cili është konstrukt dëshiror, që do të thotë të bësh diçka të mirë), d.m.th. bërja e veprave të mira, dhe veprat e mira janë ato të cilat Allahu na ka urdhëruar t'i bëjmë. Ajo çka Allahu na ka urdhëruar të bëjmë, është ajo të cilën Ai e ka vendosur në ligj (shariat), dhe ajo që është në pajtim me Kur'anin dhe Sunetin e Pejgamberit të Tij (salallahu alejhi ue selam). Allahu na ka informuar se kushdo që e pastron qëllimin e tij për hir të Allahut, dhe praktikon ihsan në veprat e mira e meriton shpërblimin dhe sigurinë nga dënimi.

Për këtë arsye, imamët e selefit (gjeneratat e para të drejta), i kombinonin këto dy koncepte, si në thënien e el-Fedhil ibn Ijad në lidhje me domethënien e thënies së Allahut: **Që ai t'u sprovtojë se cili jeni më bamirës në vepra** (Kur'an 67:2), ai tha:

“Më e sinqerta dhe më korrekte.” I është thënë atij: “O Ebu Ali, çfarë është domethënia e më e sinqerta (prej veprave) dhe më korrektja?” Ai tha: “Vërtet, çfarëdo vepre, ndonëse mund të jetë korrekte, e cila s’bëhet me sinqeritet, ajo nuk pranohet; nëse ajo bëhet me sinqeritet, por s’është korrekte, kjo po ashtu nuk pranohet, përveç nëse dhe derisa të bëhet krejtësisht për hir të Allahut, dhe vepra korrekte është ajo e cila është në pajtim me sunetin.”

Po ashtu është transmetuar nga Ibn Shahin dhe el-Lalika’i prej Se’id ibn Xhubejrit se ai ka thënë: “Asnjë thënie nuk pranohet pa vepër. Dhe asnjë thënie dhe vepër s’pranohet pa qëllim të pastër. Dhe asnjë thënie, vepër dhe qëllim s’pranohet, përveç nëse ajo është në pajtim me sunetin. Kjo thënie po ashtu është transmetuar nga el-Hasan el-Basri, i cili e përdorte fjalën “s’është e vlefshme” në vend të “s’është e pranuar”.

Në këtë ka refuzim të pozitës së sektit të quajtur Murxhia, të cilët konsiderojnë se vetëm thënia gojore (d.m.th. shprehjen e besimit) është e mjaftueshme. Më saktë, ai na informon se vepra dhe thënia janë të domosdoshme, siç kemi shpjeguar gjerësisht tjetërkund. Dhe ne kemi shpjeguar se vetëm “besimi” i zemrës, dhe shprehja e gjuhës, së bashku me praninë e urrejtjes për Allahun dhe ligjet e tija, dhe arrogancën para Allahut dhe ligjeve të Tijja, s’mund të quhet besim (iman) sipas konsensusit të besimtarëve – jo derisa ky “besim” të bashkohet me vepra të mira. Origjina e veprës është vepra e zemrës, dhe kjo është dashuria e saj, dhe respekti i madh dhe përrulja e cila eliminon urrejtjen dhe arrogancën.

Pastaj, ata vazhduan duke thënë: Thënia dhe vepra s'pranohet, përveç me qëllim të sigurtë. Kjo është e qartë: thënia dhe vepra e cila nuk ndërmerret krejtësisht për hir të Allahut, nuk pranohet nga Allahu.

Pastaj, ata vazhduan më tutje: Thënia, vepra dhe qëllimi s'pranohen, përveç nëse janë në pajtim me sunet, dhe suneti këtu do të thotë shariat (ligj). Dhe kjo është ajo çka Allahu dhe Pejgamberi i Tij kanë urdhëruar. Thënia, vepra, dhe qëllimi i cili nuk urdhërohet me sunet, me shariat, d.m.th. që Allahu ka urdhëruar është bidat (risi në fe), dhe çdo risi është shmangie, dhe s'është prej asaj çka Allahu do, ashtu që Allahu nuk e pranon atë, dhe ajo s'është e vlefshme. Shembuj janë veprat e idhujtarëve, të Krishterëve dhe Çifutëve.

## **DOMETHËNIA E “SUNETIT” NË PREDIKIMIN E SELEFIT**

Fjala “sunet” në predikimin e selefit (gjeneratave të para të drejta), e ka pasur domethënien “sunet” (d.m.th. tradita apo rruga e Pejgamberit) në aktet e adhurimit dhe në besime, ndonëse shumë prej atyre që shkruajtën në lidhje me sunetin menduan me këtë shtjellimin e besimit. Shembull për këtë është thënia e Ibn Mes'udit, Ubej ibn Ka'abit, dhe Ebi ed-Derdas (Allahu qoftë i kënaqur me ta) i cili tha:

“Përpjekjet e pakta në diçka që është sunet janë më të

pëlqyeshme se përpjekja në diçka që është bidat (risi në fe).”

Dhe Allahu është i Gjithëdijshtëm.

I tërë lavdërimi i përket Allahut. Paqja dhe përshëndetjet e Allahut qofshin mbi Muhamedin, popullin e Muhamedit, dhe shoqëruesit e tij.

Ky është fundi i fjalëve të shejh Ibn Tejmijes.

Kjo është kopjuar nga një origjinal i lashtë, prej atij që ka nevojë për mëshirën e Allahut, Meuhub ibn Ahmed ibn Hilal es-Salihi el-Hanbeli, Allahu ia faltë mëkatet me Mëshirën dhe Bujarinë e Tij. Ai e përfundoi këtë kopjim në fund të vitit 840 pas hixhretit në shkollën Islamike të njohur “el-Medrese el-Xheuzie” në Damask.

I tërë falënderimi i takon Allahut. Ai është i mjaftueshëm dhe mbrojtësi më i mirë.